



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Vendim Nr. 108/3, Datë 19.04.2019,

“Mbi korrigjimin e gabimeve materiale në Vendimin Nr.108, Datë 15.02.2019” të
Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Sot në datë 19.04.2019, ora 16:00, trupi gjykues, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Etleda Çiftja	Anëtare
Pamela Qirko	Relatore

Bazuar në nenin 112, të Kodit të Procedurave Administrative: “Korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ” sipas të cilit përcaktohet se:

- “1. Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.*
- 2. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij.”*

Trupi gjykues u mblodh për t’u njohur me kërkesën e relatores së çështjes znj. Pamela Qirko, për korrigjimin e gabimeve materiale në Vendimin e subjektit të rivlerësimit z. Hysni Demiraj.

Në Vendimin Nr.108, Datë 15.02.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në Seksionin I “RRETHANAT E ÇËSHTJES”, në fund të pikës “16.” në togfjalëshin “...në përfundim të të cilit ka konstatuar, *papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Hysni Q. Demiraj.*”, gabimisht është shkruar fjala “*papërshtatshmërinë*”, ndërsa duhej shkruar “*përshtatshmërinë*”, si dhe në Seksionin II “SEANCA DËGJIMORE”, në pikën “23.”, gabimisht është shkruar togfjalëshi “...më datë 23.07.2018, ora 9:00,...”, ndërsa duhej shkruar “...më datë 13.02. 2019, ora 12:00,...”

Trupi gjykues pasi konstatoi se kërkesa e relatores qëndron dhe pasaktësitë janë vendosur dukshëm si pasojë e gabimeve materiale, në faqen e tretë dhe të kartërt të vendimit.

V E N D O S I:

1. Në Vendimin Nr. 108, Datë 15.02.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit:
 - a. Në seksionin I “RRETHANAT E ÇËSHTJES”, në fund të pikës nr. 16, në togfjalëshin “në përfundim të të cilit ka konstatuar, *papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Hysni Qerim Demiraj*”, fjala “*papërshtatshmërinë*” të korrigjohet me fjalën “*përshtatshmërinë*”.
 - b. Në Seksionin II “SEANCA DËGJIMORE”, në pikën “23.”, togfjalëshi “...më datë 23.07.2018, ora 9:00,...”, të korrigjohet me togfjalëshin “...më datë 13.02. 2019, ora 12:00,...”
2. Të njoftojë Subjektin e Rivlerësimit, Komisionerin Publik dhe Vëzhguesin Ndërkombëtar për këtë korrigjim.
3. Vendimi i korrigjuar të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Trupi Gjykes

Roland Ilia

Kryesues

Etleda Çiftja

Anëtare

Pamela Qirko

Relatore

Sekretare gjyqesore
Olsida Goxhaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 76 Akti

Nr. 108 Vendimi
Tiranë, më 15.02.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Etleda Çiftja	Anëtare
Pamela Qirko	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, më datë 13 shkurt 2019, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i dytë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Hysni Demiraj**, gjyqtar/kryetar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE : Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Pamela Qirko, mori në shqyrtim dhe analizo shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi dhe analizo çështjen, duke u bazuar në të tri kriteret, vlerësimin pasuror, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Hysni Demiraj, ushtron detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit, z. Hysni Demiraj, i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar me shortin e hedhur, më datë 15.01.2018, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit” (në vijim “Komisioni”).
3. Në referim të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit ka filluar menjëherë, pasi janë caktuar me short trupat gjykues të Komisionit, si dhe është shortuar shpërndarja e çështjes konkrete, më datë 15.01.2018.
4. Në mbledhjen e trupit gjykues, më datë 24.01.2018, u caktua me mirëkuptim kryesuesi, z. Roland Ilia, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga asnjë anëtarë i këtij trupi, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin Hysni Demiraj.
5. Gjatë hetimit administrativ, më datë 25.09.2018, nga shtetasi A.M., gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, është depozituar denoncimi nr. *** prot., për subjektin e rivlerësimit.
6. Më datë 25.09.2018, relatorja e çështjes komisionere Firdes Shuli, ka kërkuar miratimin e kërkesës për dorëheqje për shkak të konfliktit të mundshëm të interesit.
7. Me vendimin nr. 46, datë 26.09.2018, të Kryetares së Komisionit, është vendosur ngritja e trupit gjykues për vendosjen mbi dorëheqjen e komisioneres Firdes Shuli.
8. Me vendimin nr. 2, datë 27.09.2018, është vendosur miratimi i kërkesës për dorëheqje nga procesi i rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, z. Hysni Demiraj, i komisioneres Firdes Shuli.
9. Më datë 02.10.2018, relatori i çështjes komisioner Olsi Komici, ka kërkuar miratimin e kërkesës për dorëheqje për shkak se ndodhet në konflikt interesi në hetimin e këtij procesi rivlerësimi.
10. Me vendimin nr. 49, datë 02.10.2018, të Kryetares së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është vendosur ngritja e trupit gjykues për vendosjen mbi dorëheqjen e komisioner Olsi Komicit.
11. Me vendimin, datë 05.10.2018, është vendosur miratimi i kërkesës për dorëheqje nga procesi i rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, z. Hysni Demiraj, i komisionerit Olsi Komici.
12. Me vendimin nr. 52, datë 08.10.2018, të Kryetares së Komisionit, është vendosur caktimi me short i anëtarit zëvendësues në këtë çështje, komisionere Pamela Qirko, nga e cila u deklarua mospasja e konfliktit të interesit.
13. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, pranë Komisionit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe

Konfliktit të Interesit (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim KLD).

14. Këto raporte janë administruar nga relatori, me fillimin e hetimit administrativ.

15. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. ***, datë 08.01.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

16. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontaktet të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 30.10.2017, i deklasifikuar me vendimin të KDZH-së, nr. *** prot., datë 28.03.2018, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar, *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Hysni Q. Demiraj.*

17. Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD), ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. *** prot., datë 16.04.2018.

18. Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

19. Trupi gjyqës, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 24.01.2019, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Hysni Demiraj, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

20. Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit më datë 25.01.2019. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes, më datë 28.01.2019, dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja më datë 08.02.2019.

21. Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjyqës, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

22. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, më datë 13.02.2019.

23. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 13.02.2019, ora 12:00, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jakobs.

24. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit parashitroi shpjegimet e tij në seancë, si dhe i depozitoi ato me shkrim pranë Komisionit. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

25. Z. Hysni Demiraj, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ai ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

26. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese Nr. 2/2017¹¹ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

27. **Apartament, me sipërfaqe 141.4 m²**, në bashkëpronësi me bashkëshorten, ndodhur në, “****”, nr. ***, kati ***, shkalla e *** e godinës 9-katëshe, nr. ***, regjistruar në regjistrin hipotekor me nr. ***, datë 19.07.2013, në vlerën **65.751 euro**, në pjesë takuese secili 50 %.

[1] “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

28. Garazh, me sipërfaqe 29.2 m², në katin nëntokë të ndërtesës ku ndodhet apartamenti, regjistruar në regjistrin hipotekor nr. *, datë 19.07.2013, në vlerën 8.000 euro, në pjesë takuese 50 %.**

29. Burimi i deklaruar i krijimit:

- Të ardhurat nga pagat e subjektit dhe bashkëshortes së tij;
- Paga e anëtarit të KLD-së me kohë të plotë (03.02.2006 - 06.05.2006);
- Pagesat për honorarët e mbledhjeve dhe dietat për vitet 2006 - 2011;
- Kontrata e huas me interes nr. ***, datë 27.09.2006;
- Kontrata e huas nr. ***, datë 27.08.2013;
- Kontrata e shitjes së makinave, respektivisht në vitin 2004 dhe 2016.

30. Mënyra e fitimit të pasurisë:

- Kontrata noteriale e shitjes nr. ***, datë 15.07.2013, me objekt apartament, me sip. 141.4 m², me çmim shitje 65.751 euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale me këste.
- Kontrata noteriale nr. ***, datë 15.07.2013, për garazh me sip. 29.2 m², me çmim shitje 8.000 euro, paguar jashtë zyrës noteriale me këste.
- Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente¹

31. Konkluzioni i ILDKPKI-së:

- i. Përputhet deklarimi i subjektit për pasurinë apartament, me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjet e ardhura nga ZVRPP-ja Tiranë dhe DPPP-ja.
- ii. Përputhet deklarimi i subjektit për pasurinë garazh, me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë.

32. Këto pasuri (të marra së bashku) janë deklaruar:

32.1 Në deklaratën për vitin 2007, subjekti ka deklaruar kontratë sipërmarrje (*e panoterizuar*) me shoqërinë “****” sh.p.k., për apartament 3+1, paguar dy këste nga 20.000 euro.

32.2 Në deklaratën për vitin 2013, subjekti ka deklaruar kontratën e blerjes së apartamentit të banimit nga shoqëria “****” sh.p.k., me nr. ***, datë 15.07.2013, në vlerën 65.751 euro, për apartamentin nr. ***, me sip. 141.4 m², ndodhur në “****”, si pasuria nr. ***, regjistruar në regjistrin hipotekor, nr. ***, datë 19.07.2013.

32.3 Burimi i krijimit, kontratë e huas me shtetasin P.K., nr. ***, datë 27.09.2006, si dhe kontratën e huas, nr. ***, datë 27.08.2013, në shumën 30.000 euro (prej të cilave është deklaruar se janë përdorur 2.500.000 lekë).

¹ Vërtetim nga dokumente hipotekorë nr. ***, datë 19.07.2013.

Kontratë shitje pasurie e paluajtshme, nr. ***, datë 15.07.2013.

Vërtetim nga dokumente hipotekorë nr. ***, datë 19.07.2013.

Kontratë shitje pasurie e paluajtshme nr. ***, datë 15.07.2013.

32.4 Në deklaratën për vitin 2009, subjekti ka deklaruar, kontratë sipërmarrje nr. ***, datë 15.07.2009, me shoqërinë “****” sh.p.k., për ndërtimin e garazhit në pallatin ku jeton, kati nëntokë, Kulla “****”, pagimi i shumës 12.500 euro me këste të përcaktuara.

32.5 Në deklaratën për vitin 2010, subjekti ka deklaruar se ka pronotuar garazh nga shoqëria “****” sh.p.k., me sip. 15 m², në vlerën 12.500 euro për të cilën ka paguar 4.000 euro dhe ka deklaruar se kanë mbetur për t’u paguar 8.500 euro.

32.6 Në deklaratën për vitin 2011, subjekti ka deklaruar detyrimin ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., për blerje garazhi në vlerën 12.500 euro, për të cilin ka shlyer shumën prej 2.000 eurosh dhe se i kanë mbetur pa shlyer shuma prej 6.500 eurosh.

32.7 Në deklaratën për vitin 2012, subjekti ka deklaruar detyrimin ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., për blerje garazhi në shumën prej 12.500 eurosh, për të cilën ka deklaruar se ka shlyer shumën 500 euro dhe se i kanë mbetur për t’u shlyer shuma prej 6500 eurosh.

32.8 Në deklaratën për vitin 2013, subjekti ka deklaruar kontratën e blerjes së garazhit nga shoqëria “****” sh.p.k., me nr. ***, datë 15.07.2013, me sip. 29.2 m² e regjistruar, për të cilën ka deklaruar se ka shlyer 2.000 euro.

32.9 Burimi i krijimit të deklaruar, nga huaja e marrë nga personi tjetër i lidhur, vëllai i subjektit, sipas kontratës përkatëse të huas (për të cilën është hetuar dhe shpjeguar më poshtë) në shumën 30.000 euro. Në këtë deklaratë subjekti ka deklaruar se ka likuiduar totalisht këtë pasuri.

32.10 Në deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar, bashkëpronësi me bashkëshorten në një apartament, me sip. 141.4 m², nr. ***, kati ***, shkalla ***, godina 9-katëshe, nr. ***, “****”, regjistruar në regjistrin hipotekor me nr. ***, datë 19.07.2013, në vlerën 65.751 euro, në pjesë takuese secili 50 % dhe garazh, me sip. 29.2 m², ndodhur në katin nëntokë të po këtij apartamenti.

✓ Hetimi i kryer nga Komisioni²

33. Analiza e provave:

33.1. Nga aktet rezulton se subjekti i rivlerësimit ka porositur pranë shoqërisë “****” sh.p.k., më datë 15.06.2007, një apartament me sip. 159.5 m², Kulla “****”, në shumën 65.701 euro, me kusht që kjo shumë të likuidohet brenda vitit 2009. Në fakt shuma është likuiduar pjesërisht në vitin 2007 dhe plotësisht me formalizimin e kontratës së shitjes, datë 15.07.2013.

33.2 Sipas mandatarkëtimeve nr. ***, datë 18.04.2007 dhe nr. ***, datë 15.06.2007, të depozituara nga shoqëria ndërtimore “****” sh.p.k., subjekti ka paguar paraprakisht dy këste në shumën 20.000 euro dhe në korrik 2013 ka përfunduar shlyerjen e pagesës së kësaj pasurie me shumën 25.571 euro. Konstatohet se një këst është paguar, më datë 18.04.2007, dy muaj përpara nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes. Gjithashtu, konstatohen mospërputhje në sipërfaqen e apartamentit të porositur krahasuar me atë të finalizuar në kontratën e shitjes. Konkretisht, sipërfaqja e apartamentit në kontratën e sipërmarrjes është specifikuar 159.5 m², ndërsa në kontratën e shitjes ajo është specifikuar 141.4 m².

²Shkresë nr. *** prot., datë 25.01.2018, drejtuar ZVRPP-së Tiranë.

Shkresë nr. *** prot., datë 25.01.2018, drejtuar UKT-së.

Shkresë nr. *** prot., datë 25.01.2018, drejtuar Zyrës së Regjistrimit Noterial.

Shkresë nr. *** prot., datë 19.11.2018, drejtuar ALUIZNI-t.

Kërkesë për informacion dhe dokumentacion shoqërues, drejtuar shoqërisë “****” sh.p.k.

33.3 Shoqëria ndërtimore në informacionin e dhënë ka sqaruar se ZVRPP-ja nuk ka pasqyruar sipërfaqet e përbashkëta në vërtetimet e pronësisë dhe për pasojë kontrata e shitjes nr. ***, datë 15.07.2013, është lidhur vetëm për sipërfaqen e shfrytëzueshme të apartamentit 141.4 m² edhe pse shuma 65.751 euro e paguar nga subjekti ka përfshirë edhe çmimin e sipërfaqes së përbashkët të parashikuar në kontratën e sipërmarrjes lidhur mes palëve më datë 15.06.2007.

33.4 Nga hetimi i kryer është konstatuar se:

- i. Shuma 65.751 euro, e paguar nga subjekti, në raport me sipërfaqen 159.5 m², korrespondon me çmimin 412 euro/m² dhe jo 465 euro/m², sikundër specifikohet në kontratën e shitjes së pasurisë. Thënë ndryshe, shuma e paguar prej 65.751 eurosh përfaqëson vetëm përfitimin e sipërfaqes së shfrytëzueshme.
- ii. Për pasojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me çmimin e paguar për m².

→ Mbi këtë konstatim të Komisionit, subjekti në prapësimet e tij nuk depozitoi ndonjë dokument për të provuar të kundërtën.

34. Në lidhje me garazhin, nga aktet rezulton se subjekti, më datë 15.07.2009, ka porositur këtë pasuri në të njëjtën godinë në të cilën ishte porositur edhe apartamenti, në shumën 12.500 euro, por pa përcaktuar sipërfaqen e kësaj pasurie.

34.1 Për këtë pasuri, në vitin 2010 subjekti ka shlyer shumën prej 4.000 eurosh, duke deklaruar si burim krijimi të kësaj shume, tërheqjen e depozitës së bashkëshortes pranë “Raiffeisen Bank”, në vlerën 340.000 lekë.

34.2 Në deklaratën për vitin 2010, subjekti ka deklaruar sipërfaqen e kësaj pasurie, 15 m², ndërsa në deklaratën për “Vetting” ka deklaruar sipërfaqen 29.2 m².

34.3 Në vitin 2011, subjekti ka deklaruar se ka shlyer shumën 2.000 euro, në vitin 2012 shumën 500 euro dhe në vitin 2013 shumën prej 2.000 eurosh. Në tërësi subjekti ka shlyer shumën 8.500 euro.

34.4 Në kontratën e shitjes rezulton se kjo pasuri është blerë në shumën 8.000 euro.

34.5 Nga subjekti është deklaruar³ se: “... çmimi i garazhit ka ndryshuar nga 12.500 euro në 8.000 euro, në marrëveshje me shoqërinë sipërmarrëse, për shkak të cilësisë së dobët të punimeve në garazh”.

34.6 Mbi këtë konstatim, i është kërkuar informacion dhe dokumentacion provues shoqërisë dhe njëkohësisht është pyetur edhe subjekti.

34.7 Shoqëria ka vënë në dispozicion procesverbalin e dorëzimit të pasurisë së vitit 2013, në të cilën deklaron se, për cilësinë e dobët të punimeve në garazh, shuma për blerjen e tij është përcaktuar 8.000 euro. Shoqëria nuk ka saktësuar lidhur, me sip. 15 m², të kësaj pasurie të deklaruar nga subjekti në vitin 2010, me atë të përfituar në kontratën e shitjes, më sip. 29.2 m².

34.8 Në lidhje me deklaramin e shumës 500 euro të paguar në vitin 2012, është pyetur subjekti, nga ku ka sqaruar⁴ se: “...Është i saktë konstatimi i juaj se janë paguar 500 euro më tepër, provuar kjo dhe pas interesimit tim pranë firmës, rezulton se këto pagesa janë kryer për të mbuluar shpenzimet shtesë elektrike dhe janë shënuar gabim si pagim i kësteve të garazhit nga ana ime por që është qartësuar përfundimisht nga shoqëria ndërtimore. Pranë jush po paraqes dhe faturën e gjetur pranë shoqërisë”.

³ Shih deklaratën për vitin 2013, në dosjen e Komisionit.

⁴ Shih përgjigjet e pyetësorit, datë 07.09.2018, në dosjen e Komisionit.

34.9 Subjekti ka vënë në dispozicion:

34.9.1 Mandatarkëtim nr. ***, datë 02.02.2012, në të cilin pasqyrohet shuma 500 euro me përshkrim “*për shtesa elektrike*”

34.10 Nga hetimi i kryer është konstatuar:

- i. Mospërputhje midis deklaramit të bërë në deklaratën “Vetting” dhe deklaratën për vitin 2013, ku subjekti ka deklaruar sip. 29.2 m², me deklarimin e bërë në vitin 2010 ku subjekti ka deklaruar sipërfaqen 15 m².
- ii. Subjekti ka kryer deklarim të pasaktë në lidhje me shumën e shpenzuar për blerjen e pasurisë, për shkak se ka deklaruar nga viti 2010 deri në vitin 2012 shumën 12.500 euro, ndërsa në vitin 2013 ka deklaruar shumën 8.000 euro.

➔ Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ndër të tjera ka shpjeguar se: “*.. fakti që kam deklaruar në vitin 2010 se sipërfaqja e garazhit është 15 m² e shpjegoj se mund të jetë një gabim material, pasi në asnjë dokument tjetër nuk specifikohet ky fakt...*”

➔ Në analizë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, nuk rezultoi të provohej e kundërta dhe për pasojë konstatimet e Komisionit janë të drejta të bazuara në fakte e rrethana të pakundërshtueshme.

34.11. Komisioni hetoi lidhur me mundësinë e subjektit për të përfutur me çmim preferencial, në blerjen e pasurive, në raport me shtetasit e tjerë si blerës në të njëjtën godinë, për shkak të funksionit të tij.

- Analiza e dokumentacionit⁵ të vënë në dispozicion nga ZVRPP-ja Tiranë.

34.12 Në aktet e administruara, Komisioni u ndal për të hetuar kryesisht disa prej kontratave, që i përkasin përafërsisht, të njëjtit vit, me atë në të cilin subjekti ka nënshkruar porosisë apo edhe blerjen, pavarësisht sipërfaqes, si dhe mënyrës së likuidimit të shumës së shpenzuar për blerjen e pasurive.

34.13 Nga verifikimi i dokumentacionit u përzgjedhën disa kontrata nga të cilët rezulton se:

34.13.1 Shtetasja M.K., ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k., me kontratën e shitjes nr. ***, datë 25.07.2013, apartamentin me sipërfaqe 89.3 m², në shumën 72.720 euro.

34.13.2 Shoqëria “****” sh.p.k., ka blerë nga shoqëria “****”, sh.p.k, me kontratën e shitjes nr. ***, datë 22.01.2013, apartamentin me sipërfaqe 73.8 m² (pasuria me nr. ***), në shumën 71.230 euro. Në kontratë në nenin 2 të saj është pasqyruar ekzaktësisht se vlera e apartamentit është likuiduar nga pala blerëse jashtë zyrës noteriale me këste, në bazë të kontratës së porosisë nr. ***, datë 12.09.2007.

34.13.3 Shtetasja L.K., ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k, me kontratën e shitjes nr. ***, datë 08.04.2014, apartamentin me sip. 120.3 m² dhe verandë me sip.160.5 m² (pasuria me nr. ***), në shumën 140.400 euro. Në kontratë në nenin 2 të saj është pasqyruar ekzaktësisht se vlera e apartamentit është likuiduar nga pala blerëse jashtë zyrës noteriale me këste, në bazë të kontratës së porosisë (pa përcaktur numra dhe datë).

⁵ Referojuni dokumentacionit bashkëngjitur shkresës nr. ***prot., datë 05.12.2018 të ZVRPP-së Tiranë në dosjen e Komisionit.

34.13.4 Shtetasi I.C, etj, kanë blerë nga shoqëria “****” sh.p.k., me kontratën e shitjes nr. ***, datë 26.07.2013, apartamentin me sip. 81.9 m² (pasuria me nr. ***), në shumën 38.500 euro. Në kontratë në nenin 2 të saj është pasqyruar ekzaktesisht se, vlera e apartamentit është likuiduar nga pala blerëse jashtë zyrës noteriale me këste.

34.13.5 Shtetasja N.S, ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k., me kontratën e shitjes nr. ***, datë 15.07.2013, apartamentin me sip. 197.6 m² (pasuria me nr. ***, në shumën 98.800 euro). Në kontratë në nenin 2 është pasqyruar ekzaktesisht se vlera e apartamentit është likuiduar nga pala blerëse jashtë zyrës noteriale me këste sipas kontratës së sipërmarrjes.

34.13.6 Shtetasi N.S., ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k., me kontratën e shitjes nr. ***, datë 15.07.2013, garazhin nr. ***, me sip. 14.7 m², në shumën 8.000 euro. Në kontratë në nenin 2 është pasqyruar ekzaktesisht se vlera e garazhit është likuiduar nga pala blerëse jashtë ... sipas kontratës së sipërmarrjes. Ky shtetas ka blerë edhe një garazh tjetër po me këtë çmim.

34.13.7 Në kontratën e shitjes së pasurisë, nr. ***, datë 18.08.2014, shtetases D.M. i është shitur apartament, me sip. 99 m², në shumën 70.700 euro, shumë kjo e likuiduar po sipas një kontrate porosie të nënshkruar në këtë vit.

34.13.8 Në kontratën e shitjes nr. ***, datë 27.01.2014, shtetasit N.J. i është shitur pasuria apartament, me sip. 73.8 m², në shumën 62.475 euro, shumë kjo e likuiduar sipas një kontrate sipërmarrje të vitit 2009.

34.13.9 Në kontratën e shitjes nr. ***, datë 09.10. 2013, të pasurisë, apartament, shtetasit I.D. i janë shitur 2 garazhe me sipërfaqe secili 14.7 m², në shumë secili nga 8.000 euro.

34.13.10 Në kontratën e shitjes nr. ***, datë 19.11.2015, shtetases I.SH. i është shitur një apartament, me sip. 56.9 m², në shumën 41.730 euro dhe një garazh me sip. 13.5 m², në shumën 9.000 euro, shuma të cilat pasqyrohen të likuiduara sipas kontratës së sipërmarrjes datë 26.10.2006.

34.13.11 Sipas kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 12.05.2006, shtetasi XH.L., ka porositur për ndërtim pranë shoqërisë “****” sh.p.k., disa apartamente, dyqane dhe garazhe në funksion të lejes së ndërtimit nr. ***, datë 20.03.2006 dhe vendimit nr. ***, datë 08.02.2006, që kjo shoqëri ka marrë për të ndërtuar një godinë banimi në “****”. Në kontratë është përcaktuar se porositësi do t’i paguajë sipërmarrësit 500 euro/m² në apartamente, 7.000 euro për garazh dhe 800 euro/m² për dyqane.

34.13.12 Shtetasja S.M me kontratën e sipërmarrjes nr. *** kol, datë 25.05.2006, ka porositur apartament në këtë shoqëri, me sip. 106.9 m², në shumën 80.175 euro, me çmim 750 euro/m².

34.13.13 Shtetasja S.C. me kontratën e shitjes nr. ***, datë 18.12.2013, ka blerë apartamentin me sip. 67.6 m², në shumën 45.000 euro (rreth 660 euro/m²), shumë e likuiduar në bazë të kontratës së porosisë.

34.13.14 Shtetasi A.M. rezulton të ketë blerë me kontratën e shitjes nr. ***, datë 28.08.2013, apartamentin me sip. 59.5 m², në shumën 27.668 euro me çmim 465 euro m².

34.13.15 Shtetasi me mbiemër “B” ka blerë me kontratën nr. ***, datë 09.10.2013, apartamentin me sip. 67.6 m² në shumën 50.700 euro me çmim 750 euro/m².

34.13.16 Shtetasi me mbiemër “I” me kontratën nr. ***, datë 09.04.2014, ka blerë nga kjo shoqëri apartament, me sip. 120.6 m² në shumën 101.304 euro likuiduar sipas kontratës së porosisë.

Nr.	Pasuria e paluajtshme, kontratë nr. rep/kol.	Data	Sip. m ²	Vlera Euro	Çmimi euro/m ²
***	Nr. ***	25.07.2013	89.3	72.720	814.3

***	Nr. ***	22.01.2013	73.8	71.230	965.17
***	Nr. ***	08.04.2014	120.3+160. 5 verandë	140400	700.00
***	Nr. ***	26.07.2013	81.9	38.500	470.0
***	Nr. ***	15.07.2013	197.6	98.800	500.6
***	Nr. *** (garazh)	15.07.2013	14.7	8.000	
***	Nr. ***	18.08.2014	99	70.700	714.0
***	Kont. sip. E V. 2009	27.01.2014	73.8	62.475	846.5
***	Dy garazhe me çmim secili, Nr. *** dhe Nr. ***	09.10.2013	14.7	8000	
***	Nr. ***	19.11.2015	56.9	41.730	733.3
			13.5	9.000	
***	Nr. ***, (disa apartamente)	12.05.2006			500.0
	Garazh			7.000	
	Dyqane				800.0
***	Apartament	25.05.2006	106.9	80.175	750.0
***	Apartament	18.12.2013	67.6	45.000	665.7
***	Apartament	28.08.2013	59.5	27.668	465.0
***	Apartament	9. 10.2013	67.6	50.700	750.0
***	Apartament	09.04.2014	120.6	101.304	840.0

34.14. Nga hetimi i kryer, Komisioni, ka konstatuar se:

- i. Raporti i shumës së shpenzuar (për m²), nga ana e subjektit të rivlerësimit, për blerjen e pasurisë, *apartament* dhe *garazh*, është më i ulët se shumata e shpenzuara (për m²) nga shtetas/blerës të tjerë, referuar përparësisht kohës në të cilën subjekti ka porositur pasuritë, por edhe kohës kur ai ka formalizuar kontratën e shitjes së tyre.
- Pas kalimit ta barrës së provës, subjekti në shpjegimet e tij, ka cituar disa kontrata të tjera shitblerje të viteve 2016 deri 2018, të shtetasve të tjerë për blerje të pasurisë garazh dhe kontrata të vitit 2013 për blerje apartamenti, por nuk ka depozituar kopje të tyre, për të provuar se nuk është trajtuar me çmim preferencial, si dhe ka vënë në dispozicion një akt ekspertimi të vlerësimit të pasurisë garazh, datë 30.01.2019.

34.15 Në konkluzion:

Komisioni nisur nga fakti se:

- i. Subjekti i rivlerësimit është përfshirë në konflikt të hapur interesi me përfaqësuesit e shoqërisë ndërtimore⁶ ku edhe ka përfituar pasuritë e lartpërmendura, objekt i këtij hetimi administrativ.
- ii. Çmimi për metër katror i blerjes së pasurisë rezultoi më i ulët se çmimi i përcaktuar në kontratë.
- iii. Shuma e paguar për pasurinë garazh rezultoi të jetë në raport të zhdrejtë me shumën e paguar sipas kontratave të tjera të shitblerjeve për të njëjtin lloj pasurie, “garazh”.
- iv. Shuma 8.000 euro për blerjen e garazhit është saktësuar vetëm në deklaratën për vitin 2013, kohë në të cilën subjekti ka zhvilluar edhe procesin gjyqësor me përfaqësuesit e kësaj shoqërie ndërtimore, në ndryshim nga shumën e deklaruar në vitet e mëparshme, shuma prej 12.000 eurosh.
- v. Kontratat e cituara në prapësimet e paraqitura si dhe akti i ekspertimit nuk ndikojnë në raport me konstatimet e bëra nga Komisioni.

Komisioni, krijon bindjen se subjekti i rivlerësimit është trajtuar me çmim preferencial në përfitimin e pasurisë apartament dhe garazh, duke pasqyruar si pasojë edhe realizimin e kontratave fiktive për blerjet e këtyre pasurive.

35. Lidhur me burimin e krijimit të të ardhurave për blerjet e pasurive të marra së bashku.

35.1 Hua në shumën 5.000.000 lekë, marrë shtetasit P.M.K., në vitin 2006, me kontratën e huas nr. ***, datë 27.09.2006.

35.2 Hetimi i kryer nga Komisioni⁷

Analiza e provave:

35.3 Kontrata e huas nr. ***, datë 27.09.2006, është lidhur midis huadhënësit P.K. dhe subjektit të rivlerësimit në cilësinë e huamarrësit, në shumën 5.000.000 lekë. Në kontratë është parashikuar se huaja do të përdoret për blerje të një banese. Gjithashtu, është parashikuar afati i kthimit të saj për 12 vite, me datë përfundimi 01.10.2018 dhe se ajo do të shlyhet me këste vjetore të ndara në 12 këste gjithsej, me interes 2.5 %. Qëllimi për marrjen e huas është deklaruar nga subjekti edhe në deklaratën për vitin 2006, me përshkrim se, *...shkaku i saj është fillimi i punës pranë KLD-së me kohë të plotë por e përcaktuar për çmimet e larta të tregut, etj.*

35.4 Me huan e marrë, është bërë pagimi i dy kësteve në vlerën 20.000 euro për blerjen apartamentit 3+1, sipas kontratës së sipërmarrjes më datë 15.06.2007⁸.

Duke qenë se me shtetasin P.M.K., subjekti i rivlerësimit ka hyrë në marrëdhënie juridike të huadhënies dhe se, huaja ka shërbyer si burim krijimi i një pasurie të paluajtshme, janë kryer hetime bazuar në nenin 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, nëse ky shtetas me cilësinë e huadhënësit justifikon ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës 5.000.000 lekë.

35.5 Sipas informacionit bankar, rezultoi se shtetasi P.K., ka llogari rrjedhëse në euro dhe në lekë si dhe depozitë në lekë pranë “Intesa Sanpaolo Bank”. Llogaria rrjedhëse nr. ***, në monedhën

⁶ Çështje trajtuar hollësisht në shkronjën “****” në këtë vendimarrje.

⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 02.11.2018, drejtuar Bankës së Shqipërisë, të gjitha bankave të nivelit të dytë si dhe institucioneve jo bankare. Shkresë nr. *** prot., datë 06.11.2018, drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastër. Shkresë nr. *** prot., datë 07.12.2018, drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastër.

⁸ Shih deklarinimin për vitin 2007 në dosjen e ILDKPKI-së si dhe dokumentet bashkëngjitur pyetësorit të datës 14.02.2018, në dosjen e Komisionit.

euro, më datë 08.08.2006, rezulton të jetë kredituar me transfertë nga shtetasi K.K., në shumën 100.000 euro. Gjithashtu, më datë 09.08.2006, z. P.K., ka depozituar *cash* shumën prej 100.000 eurosh. Më tej, ky i fundit ka transferuar të dy shumat në llogarinë e tij personale në të njëjtin numër llogarie. Nuk rezulton që kjo shumë të jetë tërhequr deri më datë 09.01.2007, ndërsa huaja subjektit të rivlerësimit i është dhënë në shtator 2006. Gjithashtu, edhe sipas informacionit të marrë nga "Tirana Bank", rezulton se huadhënësi ka llogari në monedhën euro, lekë, dollarë përgjatë periudhës 2003 - 2014, por gjithnjë duke iu referuar periudhës në të cilën ai ka dhënë huan, nuk rezultojnë të jenë kryer transaksione dhe për pasojë burimi i krijimit të saj mbetet i pa provuar ligjërisht. Pra, në tërësi, nga vlerësimi i informacionit të ardhur nga të gjitha bankat e nivelit të dytë për llogaritë bankare të shtetasis P.K., nuk rezulton që ky i fundit të ketë pakësuar gjendjen e likuiditeteve në bankë për të dhënë hua/borxh shumën prej 5.000.000 lekësh, subjektit të rivlerësimit, z. Hysni Demiraj. Gjithashtu, lidhur me zhvillimin e aktivitetit të tij, nga QKB-ja rezulton se shoqëria "****" sh.p.k., është regjistruar, më datë 06.11.1998, me administrator znj. S.N., ndërsa z. P.K. rezulton të jetë ortak me 26 % pjesë të kapitalit të shoqërisë. Më datë 27.03.2007, me vendim të asamblesë së ortakëve është vendosur shitja e kuotave të ortakut P.K., i cili i ka shitur kuotat e tij ortakëve të tjerë.

35.6 Shoqëria "****" sh.p.k., është regjistruar, më datë 06.04.2004, me NIPT ***, me përfaqësues ligjor dhe ortak, z. A.T., dhe më datë 23.01.2008 (vit i cili daton pas dhënies së huas) pranë kësaj shoqërie është shtuar si ortak me 45 % të kapitalit, shtetasi P.K.

35.7 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve⁹ dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë ka informuar për të ardhurat dhe fitimin neto të realizuar nga shoqëritë "****" sh.p.k., me NIPT *** dhe "****" me NIPT *** (për këtë të fundit huadhënësi pasqyrohet si ortak vetëm në vitin 2008, kohë e cila nuk përkon me dhënien e huas) si vijon:

Shoqëria "**" sh.p.k me NIPT *****

Viti	Të ardhurat lekë	Fitimi neto lekë	Fitimi i mbartur sipas pasqyrave financiare
1999	52,508,950	4,479,918	4,347,079
2000	61,526,700	6,366,100	10,713,179
2001	115,689,417	5,301,460	16,014,639
2002	114,368,225	4,668,624	20,683,263
2003	120,803,480	6,056,437	25,739,700
2004	122,352,589	5,916,757	31,656,457
2005	125,353,910	5,271,862	0

35.8 Me vendim të asamblesë së ortakëve, më datë 11.01.2006, është vendosur zmadhimi i kapitalit themeltar me fitimet e mbartura dhe më datë 20.01.2006, është vendosur miratimi i aktit të ekspertit kontabël për të rritur kapitalin themeltar në vlerën 31.800.000 lekë, i cili pas zmadhimit arrin në vlerën 31.900.000 lekë.

⁹ Shih shkresën nr. *** prot., datë 14.11.2018, në dosjen e Komisionit.

35.9 Deri në janar të vitit 2006 shtetasi P.K. nuk ka përfiturar të ardhura nga shoqëria sepse nuk rezulton të jenë ndarë dividendë për ortakët, pasi i gjithë fitimi i mbartur nga viti 1999-2004 është përdorur për zmadhim kapitali themeltar të shoqërisë.

35.10 Me shkresën nr. *** prot., datë 21.12.2018, Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë ka dërguar dokumentacionin përkatës lidhur me aktivitetin e shoqërisë "****" (***) sh.p.k., me NIPT ***. Në dokumentacion është administruar një kopje e shkresës të dërguar nga shoqëria "****" sh.p.k., Gjirokastrë, më datë 20.06.2006, me lëndë: "Ju dërgojmë vendimin e shoqërisë mbi destinacionin e fitimit të shoqërisë të vitit 2005", në të cilën deklarohet se: "*Ortakët e shoqërisë "****" në mbledhjen e tyre kanë vendosur që fitimi i pasqyruar në bilancin e vitit 2005 të kalojë në kapital, çka vërteton se edhe në vitin 2006 nga kjo shoqëri nuk është shpërndarë dividend për ortakët e shoqërisë*".

35.11 Në kontratën për shitje kuotash nr. ***, datë 28.02.2007, rezulton se shtetasi P.K. ka shitur ½ e 33.3 % të kuotave që zotëron me një vlerë të përgjithshme prej 5.300.000 lekësh.

35.12 Nga hetimi i kryer dhe analiza financiare, Komisioni ka konstatuar se:

i. Huadhënësi nuk ka pasur në dispozicion likuiditete, në vitin 2006, për të dhënë hua subjektit, në shumën 5.000.000 lekë.

➔ Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka parashtruar pretendimet e tij, si dhe ka vënë në dispozicion dokumente për të provuar indirekt mundësinë e huadhënësit për të dhënë hua, si kontratë kredimarrje apo akte për blerje makinash prej tij, por pa mundur të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të krijuara, me qëllim dhënien e huas.

35.13 Në lidhje me aftësinë paguese të huas nga subjekti i rivlerësimit.

35.13.1 Në deklaratimet periodike është deklaruar rregullisht vit pas viti mënyra e shlyerjes së detyrimit të shumës prej 5.000.000 lekësh të shtetasi P.K.

35.14 Hetimi i kryer nga Komisioni:

35.14.1 Subjekti është pyetur lidhur me mënyrën e likuidimit të huas, nga ku ka deklaruar¹⁰ se: "*...Unë pagesat e kryera gjatë viteve të ndryshme për shlyerjen e huas së marrë nga shtetasi P.K. i kam bërë ndër vite në cash, pranë personit, kryesisht pranë hotel "****" ku P. kishte pjesë në pronësi si dhe i kam deklaruar në çdo deklaram vjetor. Kjo provohet dhe me deklaratën noteriale të shtetasit P.K., nr. ***, datë 15.09.2018, që po e paraqes pranë jush*".

35.15 Subjekti ka vënë në dispozicion:

35.15.1 Deklaratën noteriale, nr. ***, datë 15.09.2018, të noteres L.M.

Analiza e provave:

35.16 Me deklaratën noteriale, nr. ***, datë 15.09.2018, huadhënësi ka deklaruar se ka përfunduar ekzekutimi i shlyerjes së huas së dhënë dhe se ai nuk ka pranuar të marrë interesat e shënuara në kontratë. Në kushte të tilla, Komisioni bëri përllogaritjet financiare duke mos marrë në konsideratë në shlyerjen e kësteve interesat e përcaktuara në kontratën e huas.

¹⁰ Shih përgjigjen e pyetjes 7 në pyetësorin nr. 2, datë 07.09.2018, në dosjen e Komisionit.

Në tabelën më poshtë pasqyrohet gjendja financiare e subjektit të rivlerësimit vit pas viti.

Nr.	Përshkrimi/ Viti	Viti 2008	Viti 2010	Viti 2011	2012	2013	2014	2015
	Pasuritë	32,880	-396,476	-3,998	-886	3,702,528	-2,557	-1,412
1	Likuiditete	32,880	-396,476	-3,998	-886	98,934	-2,557	-1,412
2	Apartament banimi 3+1 , Sip. 159.5 m2	0	0	0	0	3,603,594	0	0
	Të ardhurat	1,269,889	1,230,284	1,207,359	1,223,403	1,322,399	1,315,899	1,325,842
1	Nga paga	926,006	1,230,284	1,207,359	1,223,403	1,222,399	1,315,899	1,325,842
2	Paga e bashkëshortes	294,685	0	0	0	0	0	0
3	Pedagog te Universiteti Akademia e Biznesit	0	0	0	0	100,000	0	0
	Detyrimet	-600,000	-1,155,240	-576,600	-569,860	2,925,880	-500,000	-575,300
1	Hua nga P. K.	-600,000	-600,000	-300,000	-500,000	-1,000,000	-500,000	-300,000
2	Detyrim ndaj sh. ndërtimit për garazh	0	-555,240	-276,600	-69,860	-280,420	0	0
3	K. huaje R. D.	0	0	0	0	4,206,300	0	-275,300
	Shpenzime	736,546	658,546	807,186	658,546	700,609	831,876	872,858
1	Për qira banese	72,000	0	0	0	0	0	0
2	Shp. jetike	654,546	654,546	654,546	654,546	654,546	654,546	654,546
3	Për udhëtime jashtë shtetit	10,000	4,000	152,640	4,000	46,063	177,330	178,650
	Diferenca	-99,537	-187,026	-172,429	-4,117	-154,858	-13,420	-120,904

35.17 Nga hetimi i kryer dhe analiza financiare, Komisioni, ka konstatuar se:

- ✓ Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për shlyerjen e kësteve të huas vit pas viti.
- ➔ Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka pretenduar se Komisioni nuk ka përlloritur kursimet e tij në shumën 500.000 lekë të cilën e ka përdorur gjithnjë si rezervë. Pretendimi i subjektit nuk qëndron pasi e njëjta shumë është deklaruar dhe përdorur për të bërë zhdoganimin, etj., të një automjeti të blerë nga subjekti, për të cilën është arsyetuar më poshtë në këtë vendim.

35.18 Në konkluzion:

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dokumentet e depozituara, çmon se ato mbeten në nivel deklarativ dhe për pasojë, konstatimi i bërë, se huadhënësi ka qenë në pamundësi financiare për të dhënë hua dhe se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për shlyerjen e saj, është i drejtë, i bazuar në nivel faktesh dhe provash të pakontestueshme.

Gjithashtu, Komisioni, në vlerësimin tërësor të veprimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit lidhur me marrjen dhe shlyerjen e huas nga/tek shtetasi P.K. ka vërejtur se:

- i. Vlera e parashikuar në marrëdhënien kontraktore (huamarrja) është ekzekutuar pa përfshirë interesin mbi principalin, të përcaktuar mes palëve;
- ii. Në ato vite marrja e kredive bankare karakterizohej nga vlera interesash relativisht të lartë deri në 12.9 %;
- iii. Vlera e huas sipas deklarimeve të vetë subjektit në seancën dëgjimore (pasi është pyetur edhe nga vëzhguesi ndërkombëtar) *është dhënë në zyrë të tij, cash në vlerën 5.000.000 lekë shqiptare.*
- iv. Huadhënësi ka deklaruar se ka pranuar shlyerjen e huas pa përfshirë interesin përkatës, vetëm gjatë hetimit administrativ.
- v. Subjekti në asnjë deklaratë periodike nuk ka deklaruar lidhur me shlyerjen ose jo të interesit mbi huan e dhënë.

Për të gjithë arsyet e lartpërmendura, Komisioni, ka krijuar bindjen se subjekti edhe në marrjen e kësaj huaje është përfshirë në marrëdhënie pasurore preferenciale dhe se me veprimet/sjelljen e tij ka cenuar rëndë etikën e gjyqtarit, duke cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

36. Hua në shumën 30.000 euro, marrë nga personi tjetër i lidhur, vëllai i subjektit të rivlerësimit, shtetasi R.D.

36.1 Burimi i deklaruar i krijimit:

36.2 Kontratë e shitjes së shtëpisë së banimit në qytetin e Bajram Currit nga vëllai i subjektit, z. R.D.

36.3 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë huaje, nr. ***, datë 27.08.2013.
- Kontratë shitje pasurie e paluajjtshme, nr. ***, datë 6.11.2006.
- Kontratë pune, nr. ***, datë 11.03.2011.
- Licencë nr. ***, nga Ministria e Punëve Publike dhe Telekomunikacionit e regjistruar, më datë 04.08.2008, me drejtues teknik, znj. B.D.
- Kontratë pune, datë 01.01.2012.
- Kontratë pune, nr. ***, datë 20.01.2007.

36.4 Hetimi i kryer nga Komisioni¹¹

Analiza e provave:

36.5 Me kontratën e huas, nr. ***, datë 27.08.2013, shtetasi R.D. (vëllai i subjektit) i ka dhënë hua subjektit të rivlerësimit shumë 30.000 euro me afat shlyerje deri, më datën 26.08.2023, me shlyerje të menjëhershme dhe pa interes. Kontrata ka parashikuar se kjo shumë është dhënë për të likuiduar subjektin e rivlerësimit një apartament banimi.

36.6 Është konstatuar se kontrata e huas është lidhur, më datë 27.08.2013, pas shlyerjes përfundimtare të blerjes së pasurisë, më datë 15.07.2013.

36.7 Mbi këtë konstatim është pyetur subjekti nga ku ka sqaruar:¹² “...kalimi i shumës së huas është bërë në kushte të mirëbesimit midis vëllezërve para datës 15.07.2013, por palët janë paraqitur te noteri për të materializuar veprimin juridik të huas që më datën 27.08.2013.

Huaja prej 30.000 eurosh është përdorur¹³ si vijon:

- Shuma prej 25.000 eurosh, i është paguar shoqërisë “***” sh.p.k., si pjesë e çmimit të blerjes së apartamentit 3+1, sipas kontratës së porosisë, më datë 15.06.2007.¹⁴

- Shuma prej 2.000 eurosh për të likuiduar tërësisht vlerën e garazhit.

- Pjesa e mbetur, është përdorur për pagimin e huas (prej 5.000.000 lekësh) në shumën 1.000.000 lekë”.

36.8 Gjithashtu, subjekti është pyetur edhe lidhur me burimin e kësaj huaje, nga ku ka shpjeguar¹⁵ se: “...në lidhje me huan e marrë pranë vëllait tim R.D., dua të sqaroj se ka pasur burime të plota dhe të ligjshme për të më dhënë huan, vërtetimet zyrtare po i paraqes pranë jush, për rrogat, shitjen e dy shtëpive si dhe duhet të theksoj se vetëm shuma e pagës së licencës së kunatës B.D. dhe të pagesës së shoqatës që i ka bërë vëllait R.D., ka kapur shumën e dhënë hua pa prekur asgjë në rrogat e tyre”.

36.9 Subjekti ka vënë në dispozicion 11 vërtetime dhe dy deklarata¹⁶.

¹¹ Shkresë nr. *** prot., datë 11.09.2018, drejtuar ZVRPP-ve. Shkresë nr. *** prot., datë 13.08.2018, drejtuar Bankës së Shqipërisë, dhe të gjitha bankave të nivelit të dytë si dhe institucioneve jobankare, mbi transaksione bankare, depozita, etj, në emër të shtetasit R.D.; Shkresë nr. *** prot., datë 11.09.2018, drejtuar Bankës së Shqipërisë, dhe të gjitha bankave të nivelit të dytë si dhe institucioneve jobankare, mbi transaksione bankare, depozita, etj, në emër të shtetasit B.D.; Shkresë nr. *** prot., datë 11.09.2018, drejtuar Zyrës së Regjistrimit Noterial pranë Ministrisë së Drejtësisë; Shkresë nr. *** prot., datë 07.12.2018, drejtuar Noterit Publik, znj. M.T.; Shkresë nr. *** prot., datë 07.12.2018, drejtuar Noterit Publik, z. A.M.; Shkresë nr. *** prot., datë 19.11.2018, drejtuar Arkivit Lundër pranë ISSH-së.

¹² Shih, pyetjet e datës 14.02.2018 dhe përgjigjet e datës 26.02.2018, në dosjen e Komisionit.

¹³ Shih, deklarinin periodik për vitin 2013.

¹⁴ Shih, deklarinin për vitin 2013 dhe deklaratën “Vetting”.

¹⁵ Shih, përgjigjet e pyetësorit nr. 2, datë 07.09.2018, në dosjen e Komisionit.

¹⁶ Vërtetim nr. ***prot., datë 12.09.2018, i ZVRPP-së Tiranë; Vërtetim, datë 13.09.2018, i shoqërisë “***” sh.p.k.; Vërtetim, datë 10.08.2018, për periudhën 1 mars 2001 deri në 1 tetor 2004; Vërtetim nr. *** prot., datë 13.09.2018, i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Vërtetim nr. ***prot., datë 13.09.2018, i shoqërisë “***”; Vërtetim, datë 14.09.2018, i shoqatës “***”/Tropojë; Vërtetim për bazën e vlerësueshme nr. ***prot., datë 17.09.2018, i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Kukës; Vërtetim për bazën e vlerësueshme nr. ***prot., datë 17.09.2018, i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Kukës; Vërtetim për bazën e vlerësueshme nr. ***prot., datë 14.09.2018; Vërtetim për bazën e vlerësueshme nr.

36.10 Komisioni ka konstatuar se, subjekti në vitin 2013 ka deklaruar si burim krijimi të kësaj huaje, shitjen e shtëpisë nga vëllai i subjektit në vitin 2006 në qytetin e Bajram Currit.

36.11 Ndryshe nga më sa sipër, subjekti në pyetësor ka deklaruar si burim krijimi të kësaj huaje shitjen e dy shtëpive.

36.12 Në deklaratën për “Vetting”, subjekti ka deklaruar si në vitin 2013, por edhe të ardhurat e vëllait ndër vite.

36.13 Nga hetimi i kryer, Komisioni, ka konstatuar:

36.14 Mospërputhje lidhur me deklarinimin e bërë për burimin e krijimit të kësaj huaje.

- ➔ Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka pranuar këto mospërputhje, ka shpjeguar se ka deklaruar shitjen e shtëpisë, e cila ka qenë e hipotekuar, ndërsa nuk ka deklaruar shitjen e një shtëpie tjetër pasi nuk ka qenë e hipotekuar. Subjekti nuk paraqiti prova apo rrethana të reja për të ndryshuar konstatimin e Komisionit.

36.15 Në vijim të analizës së provave për këtë hua, nga dokumentacioni i ardhur nga ZVRPP-ja Tropojë është konstatuar se vëllai i subjektit ka pasur në pronësi të tij, të ndodhur në qytetin e Bajram Currit, pasurinë nr. ***, ZK ***, banesë, me sip. 106.2 m² e përfutur me leje ndërtimi, nr. ***, datë 12.03.1991.

36.16 Nga verifikimi dhe vlerësimi i dokumentacionit të ardhur nga bankat e nivelit të dytë në lidhje me transaksionet bankare dhe gjendjet në llogaritë bankare, për shtetasin R.D., me cilësinë e huadhënësit, në “Intesa SanPaolo Bank”, rezulton sa vijon:

- i. Në vitin 2004 ka pasur depozitë, në vlerën 5.000 USD, e zeruar në vitin 2005.
- ii. Ka pasur depozitë në vlerën 500.000 lekë, të cilën e ka shtuar në vitin 2008 me dy transaksione “Cash depozitë”, respektivisht derdhur në shumën 200.000 dhe 340 .637 lekë, si dhe interesat bankare. Më datë 06.02.2009, subjekti ka tërhequr shumën 1.185 .160 lekë duke i këmbyer në euro me kursin 126.7 lekë/euro e barabartë me 9.354 euro me përshkrim “Arsye blerje shtëpie”. Në fund gjendja e llogarisë ka rezultuar zero.

36.17 Në llogarinë bankare në euro nr. ***:

- Më datë 09.02.2009, ka depozituar *cash* shumën 32.000 euro me përshkrim “të ardhura nga shitje shtëpie”.
- Më datë 17.04.2009, ka tërhequr *cash* shumën 32.000 euro me përshkrim “blerje shtëpie”.

36.18 Në llogarinë bankare në lekë nr. ***:

***prot., datë 14.09.2018; Vërtetim për bazën e vlerësueshme nr. *** prot., datë 14.09.2018; Deklaratë noteriale nr. ***, datë 13.09.2018; Deklaratë noteriale nr. ***, datë 13.09.2018.

- Më datë 09.02.2009, ka depozituar *cash* shumën 500.000 lekë.
- Më datë 17.04.2009, ka tërhequr *cash* për blerje shtëpie, shumën 500.000 lekë.
- Në këto dy llogari, pas kësaj date, nuk ka pasur më transaksione bankare.

36.19 Nga verifikimi i dokumentacionit të ZVRPP-ve, rezulton se shtetasi R.D., me kontratë shitje pasurie të paluajtshme, nr. ***, datë 06.11.2006, i ka shitur shtetasit S.M. pasurinë e përshkruar më sipër (nr. *** të ndodhur në ZK ***, me sip. 200 m², nga kjo 106 .2 m² ndërtim, në adresën: “***”, Bajram Curri – Tropojë), në vlerën 1.500.000 lekë (rreth 12.000 euro), e cila është likuiduar totalisht përpara përpilimit të kësaj kontrate.

36.20 Në vitin 2009, vëllai i subjektit ka depozituar shumën prej 32.000 eurosh, çka nuk përkon as në vlerë dhe as në kohë me shitjen e shtëpisë.

36.21 Në këto kushte, Komisioni, ka arritur në konkluzion se vlera e shitjes së shtëpisë në vitin 2006 nuk mund të shërbejë si burim krijimi për depozitën në vlerë 32.000 euro.

36.22 Këto fonde janë tërhequr *cash*, më datë 17.04.2009, me përshkrim “blerje shtëpie”.

36.23 Bashkëshortja e personit tjetër të lidhur të subjektit të rivlerësimit, znj. B.D., rezulton të ketë kryer transaksione bankare në “Raiffeisen Bank”, si vijon:

36.24 Në llogari rrjedhëse page në lekë ka kryer këto transaksione:

- Më datë 11.07.2005, ka depozituar *cash* shumën 1.500.000 lekë.
- Më datë 16.04.2009, ka tërhequr *cash* shumën 135.600 lekë.
- Më datë 17.04.2009, ka transferuar për *shoqërinë*... shumën 2.200.000 lekë për blerje shtëpie private me përfitues shtetasin A.A.M.

36.25 Nga konfirmimi që bëjnë ZVRPP-të nëpër rrethe, nuk konstatohet blerje pasurie në emër të shtetasve R.D., B.D., apo në emër të dy bashkëshortëve së bashku, pas tërheqjes së kësaj shume.

36.26 Për shkak se transaksioni bankar është bërë për një qëllim të caktuar, “blerje shtëpie”, ndërsa në emër të tyre ZVRPP-të nuk konfirmojnë pasuri, është pyetur subjekti, nga ku ka deklaruar¹⁷ se: “...Vëllai im, shtetasi R.D., së bashku me bashkëshorten e tij, B.D., më datë 17.04.2009, kanë depozituar pranë ndërtuesit, shtetasit A.M. (në llogarinë e tij) vlerën prej 52.563 (pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre) euro, sasi kjo që ka ardhur nga konvertimi i një pjese në lekë dhe një pjesë e shumës në euro me qëllim blerjen e një apartamenti 2+1, ndodhur në, Rr: “***”, nr. ***, kati ***, hyrja nr. *** dhe së bashku kanë nënshkruar një aktmarrëveshje nga ndërtuesi, A.M. dhe vëllai im, R.D.,... Në mënyrë verbale kanë vendosur që pas një muaji të përpilojnë kontratën e shitjes... Pas rreth 2-3 muajsh, vëllai im, R.D. është vënë në dijeni se po përpiqej të blinte një apartament i cili ishte jashtë sferës së qarkullimit civil, pasi pallati ishte pa leje ndërtimi, pa vendim të dhënies së lejes për shesh ndërtimi, i pa kolauduar, i pa legalizuar dhe i pa hipotekuar. ... Ndërtuesi e ka garantuar se brenda një viti do dilte leja e legalizimit, mbështetur kjo në ligjin e ri për legalizimin e ndërtimeve informale... Pas një viti e gjysëm, më datën 10.10.2010, vëllai i ka kërkuar përsëri kthimin mbrapsht të të gjithë shumës, por kanë rënë dakord që nga e gjithë shumata t’i kthehej vlera 42.563 (dyzetë e dy mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre) euro duke lënë pranë ndërtuesit vlerën 10.000 (dhjetë mijë) euro në formë kapari për të garantuar riblerjen e apartamentit vetëm pasi të jetë formalizuar ndërtimi i pallatit, ose në të kundërt të përllogaritet qiraja e gjithë kohës së qëndrimit të tij në atë apartament. Edhe sot që komunikojmë, vëllai im R.D. banon në atë apartament....”

¹⁷ Shih përgjigjen e pyetësorit datë 19 dhjetor 2018 në dosjen e Komisionit.

- Subjekti ka vënë disa dokumente¹⁸ në dispozicion.

36.27 Nga hetimi është konstatuar se referuar rubrikës “*Efektet financiare*” në aktmarrëveshjen, datë 17 prill 2009, për marrjen në dorëzim të çelësave, por edhe faktit se ky dokument bazohej në një kontratë noteriale (sipas vetë titullit të aktit) vërehej se duhej të kishte pasur edhe një tjetër akt të mëparshëm me shoqërinë ndërtimore/ndërtuesit.

- ➔ Mbi këtë konstatim, Komisioni, për të realizuar hetim shterues në këtë drejtim, me gjithë arritjes në konkluzion nga analizimi i transaksioneve bankare si dhe dokumenteve të ZVRPP-ve, mbi të cilën mbështetet burimi i ligjshëm i të ardhurave, i ka kërkuar shpjegime subjektit.

36.28 Subjekti në prapësimet e tij ka deklaruar se nuk ka asnjë kontratë tjetër veç aktmarrëveshjes. Gjithashtu, subjekti në këto prapësime, ka parashtruar se Komisioni ka konstatuar se i vëllai i subjektit, ka pasur 52.000 euro në bankë dhe se i ka kaluar ato për llogari të shtetasit A.M. Subjekti për të provuar deklarinimin e tij nuk ka depozituar asnjë provë për të provuar të kundërtën, por ka kërkuar thirrjen në cilësinë e dëshmitarëve të shtetasve A.M. dhe A.B.

- ➔ Në analizë të këtij prapësimi, Komisioni, argumenton se në asnjë rast nuk ka bërë një konstatim të tillë lidhur me faktin e pretenduar nga subjekti, se vëllai i subjektit ka kaluar në bankë shumën 52.000 euro. Përkundrazi, Komisioni, ka argumentuar se nuk provohet burimi i ligjshëm i krijimit të shumës 32.000 euro, shumë kjo e pretenduar se ka shërbyer si burim për huan e dhënë. Për më tepër, subjekti nuk provoi qarkullimin e shumës 42.563 euro, pra kthimin e saj shtetasit A.M.

36.29 Mbi kërkimin për thirrje të dëshmitarëve, Komisioni, është shprehur me vendimin e ndërmjetëm, datë 11.02.2012, me të cilin ka vendosur mospranimin e kësaj kërkesë, pasi deklarinimet e këtyre shtetasve ishin konkretizuar në provat e depozituara nga subjekti, si aktmarrëveshje dhe deklaratë noteriale, më datë 20.12.2018, dokumente të cilat nuk prevalojnë në raport me transaksionet bankare, për të cilat Komisioni ka arsyetuar më lart në këtë vendim.

36.30 Bazuar në tërësinë e provave, Komisioni, ka konstatuar gjithashtu, se shtetasi R.D., pranë “BKT”-së ka çelur llogari bankare në vitin 2000 dhe nga data 5 mars 2012 në këtë llogari ka kaluar paga e tij. Nga transaksionet bankare rezulton se paga mujore e tij ka qenë në vlerën 31.500 lekë në muaj dhe nga viti 2015 ka qenë 41.800 lekë, shuma të cilat janë tërhequr respektivisht duke mos krijuar gjendje në bankë dhe për pasojë duke mbetur gjendja e llogarisë shpesh herë me minus. Në këtë llogari, më datë 09.08.2016, z. R.D., ka tërhequr me çek nga shoqëria “****”, shumën prej 140.000 lekësh. Në “Fibank” nuk rezulton që, z. R.D., të ketë llogari bankare, por rezulton të jetë si garantor kredie të marrë nga shtetasi M.R.B., në shumën prej 1.000.000 lekësh. Edhe sa i përket kontributeve të derdhura në favor të bashkëshortes së huadhënësit për punësimet e saj pas vitit 2012 në shoqërinë “****” sh.p.k, për të cilët ajo ka depozituar kontrata pune në dosjen e ILDKPKI-së, më konkretisht, kontratë pune nr. ***, datë 20.01.2007, midis shoqërisë “****” sh.p.k., dhe znj.

¹⁸ Aktmarrëveshje të datës 17.04.2009 midis ndërtuesit A.M. dhe personit tjetër të lidhur, shtetasit R.D.; Deklaratë noteriale nr. ***, datë 20.12.2008, e deklaruesit A.M. para noteres L.M.; Deklaratë, datë 10.10.2010; Vërtetim i Zyrës Vendore të Pasurive të Paluajtshme, datë 26.09.2018; Librezë e energjisë elektrike në emër të shtetasit R.D.

B.D. (bashkëshortja e vëllait)¹⁹, kontratë pune nr. ***, datë 11.03.2011, midis shoqërisë “****” sh.p.k., dhe znj. B.D.²⁰, kontratë individuale pune, datë 01.01.2012, midis shoqërisë “****” sh.p.k., dhe znj. B.D.²¹, të dhënat e ISSH-së nuk konfirmojnë një fakt të tillë.

36.31 Nga analiza financiare, Komisioni, konstatoi se:

- i. Duke vlerësuar të ardhurat nga paga e personit tjetër të lidhur, vëllait të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, si dhe nga transaksionet bankare, nuk rezulton që huadhënësi të ketë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të vënë në dispozicion hua në shumën 30.000 euro në vitin 2013.

➔ Pas kalimit të barrës së provës, mbi këtë konstatim, subjekti nuk ka paraqitur prova apo rrethana të reja krahasuar me ato të deklaruara apo depozituara gjatë hetimit administrativ.

37. Në lidhje me aftësinë paguese të huas në shumën 30.000 euro.

37.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën për vitin 2015 se ka shlyer vetëm shumën prej 2.000 eurosh.

37.2 Këtë fakt subjekti e ka deklaruar edhe në deklaratën “Vetting”.

37.3 Nga analiza financiare²², Komisioni, ka konstatuar se:

- i. Subjekti me të ardhurat e realizuara nga paga, nuk ka pasur mundësi financiare për të shlyer shumën 2.000 euro, si pjesë e huas së marrë vëllait të tij, z. R.D.

37.4 Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka pretenduar në përlllogaritje financiare duke pasqyruar të ardhurat, shpenzimet dhe diferencën e mbetur, sipas të cilëve provon të kundërtën.

➔ Nga rillogaritjet, Komisioni, arrin në konkluzion se konstatimi i pamundësisë së subjektit për të shlyer shumën 2.000 euro është i drejtë dhe i bazuar.

38. Në lidhje me dy kontratat e shitjes së makinave përkatësisht në vitin 2004 dhe 2016.

38.1 Kontratë shitje nr. ***, datë 13.09.2004.

38.2 Kontratë shitje automjeti nr. ***, datë 25.08.2016, në shumën 5.000 euro.

38.3 Konkluzioni i ILDKPKI-së:

Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar.

38.4 Hetimi i kryer nga Komisioni²³

Analiza e provave:

¹⁹ Shih, aneksin *** te dosja e ILDKPKI-së.

²⁰ Shih, aneksin *** te dosja e ILDKPKI-së.

²¹ Shih, aneksin *** te dosja e ILDKPKI-së.

²² Referojuni vitit 2015 në tabelën përmbledhëse 2013 - 2016 të pasqyruar në fund të rivlerësimit të pasurisë.

²³ Shkresë nr. *** prot., datë 25.01.2018, drejtuar DPSHTRR-së; Shkresë nr. *** prot., datë 25.01.2018, drejtuar Zyrës së Regjistrimit Noterial.

38.5 Në deklaratën për vitin 2003, subjekti ka deklaruar automjetin, me targë ***, të fituar me kontratë dhurimi nr. ***, datë 26.08.1997²⁴.

38.6 Me kontratën e shitjes nr. ***, datë 13.09.2004²⁵, subjekti ka shitur automjetin, me targë ***, shtetasit Dh.Z., me çmim 200.000 lekë, duke e deklaruar këtë shumë në këtë vit edhe te të ardhurat, por njëkohësisht edhe në deklaratën “Vetting”.

38.7 Me kontratën nr. ***, datë 25.09.2004²⁶, subjekti ka blerë automjetin, me targë ***, në shumën 300.000 lekë, veprim të cilin e ka deklaruar në deklaratën për vitin 2004 duke specifikuar se si burim krijimi ka shërbyer shuma prej 200.000 lekësh e përfituar në këtë vit nga shitja e automjetit të dhuruar në vitin 2003 si dhe nga shuma prej 100.000 lekësh e realizuar nga kursimet që ai ka pasur. Ky automjet më pas rezulton të ketë ndryshuar targën në ***. Kjo provohet nga të dhënat e administruara në dokumentacionin e DPSHTR-së²⁷ në të cilin konstatohet se automjeti, me targë ***, është i njëjtë me automjetin me targë ***, me shasi të njëjtë ***.

38.8 Për të konstatuar faktin nëse subjekti ka pasur mundësinë e krijimit të kursimeve për shumën 100.000 (përveç shumës 200.000 lekë të krijuar nga shitja e automjetit të dhuruar) lekë, si shumë që ka shërbyer për të blerë automjetin në shumën prej 300.000 lekësh, Komisioni ka kryer përlogaritjet financiare të pasqyruara në tabelën më poshtë.

38.9 Më tej, me kontratën e shitjes, nr. ***, datë 25.08.2016, subjekti i rivlerësimit ka shitur automjetin, me targë ***, me çmim shitje 5.000 euro²⁸. Këtë shumë subjekti e ka deklaruar si burim të ardhurash në deklarin për vitin 2016 si dhe në deklaratën “Vetting”.

38.10 Gjatë hetimit është konstatuar se, në deklaratën për vitin 2004, vlera e automjetit me targë ***, me shasi të njëjtë ***, është deklaruar në vlerën 803.000 lekë, ndërsa në kontratën e shitjes shuma pasqyrohet në vlerën 300.000 lekë. Po ashtu, Komisioni, ka konstatuar se ky automjet është shitur pas 12 viteve në shumën 5.000 euro. Për të sqaruar mbi këto paqartësi është pyetur subjekti, nga ku ka deklaruar në pyetësin nr. 2, datë 21.09.2018²⁹ ...dhe ka vënë në dispozicion dokumentacionin përkatës³⁰.

38.11 Subjekti në përgjigje të pyetësin³¹ ka deklaruar se: *“Zhdoganimi i automjetit është kryer, më datë 04.02.2005, në shumën 503.000 lekë, me burim të ardhurash gjendjen cash në banesë të deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2005... Gabimi i parë është në deklaratën e vitit 2005, ku gabimisht është shënuar se ndodhen në banesën time 500.000 lekë cash, kur në fakt ato janë përdorur për të kryer pagesat e detyrimit doganor për automjetin si dhe të gjitha pagesat për targimin e ri dhe taksat e tjera që me blerjen e disa pajisjeve si goma etj., së bashku me vlerën e 300.000 lekëve të kontratës së vitit 2004, vlera e makinës së blerë është përfundimisht 803.000 lekë e deklaruar saktë pikërisht në këtë vit.*

38.12 Komisioni duke marrë të mirëqenë deklarin e subjektit se automjeti përfaqëson shumën 803.000 lekë, ka kryer analizën financiare për të provuar faktin nëse subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të siguruar këtë shumë.

²⁴ Shih vërtetimin nr. *** prot., datë 24.10.2016, aneksi *** në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁵ Shih aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁶ Shih aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁷ Shih shkresën nr. *** prot., datë 01.02.2018 (bashkëngjitur 68 fletë me vulën e njomë të DSHPTRR).

²⁸ Shih aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁹ Shih përgjigjen e pyetjes 4 të pyetësin nr. 2, datë 07.09.2018, në dosjen e Komisionit.

³⁰ Kërkesën e subjektit të rivlerësimit me nr. *** prot., datë 11.09.2018, drejtuar DPSHTRR-së. Shkresën nr. *** prot., datë 11.09.2018, të DPSHTRR-së Gjirokastër, bashkëngjitur administrohet deklarata doganore nr. *** prot., datë 03.02.2005 dhe kontrata noteriale nr. ***, datë 25.08.2016.

³¹ Shih, përgjigjen e dhënë në pyetjen 11 (paragrafi i dytë) në pyetësin nr. 2, datë 07.09.2018, në dosjen e Komisionit.

Analiza financiare për vitet 2004, 2005

Nr.	Përshkrimi		Viti 2004	Viti 2005
	Pasuritë		1,132,644	31,905
1		LIKUIDITETE	832,644	-471,095
3		Automjet, tip "Mercedes Benz"	300,000	503,000
	Të ardhurat		1,153,848	1,031,168
1		Të ardhura nga paga	934,899	931,798
2		Paga e bashkëshortes	18,949	78,372
3		Shitja e makinës së bashkëshortes	200,000	0
5		Interesa bankare të depozitës	0	20,998
	Detyrimet		0	0
	Shpenzime		726,546	726,546
7		Për qira banese	72,000	72,000
8		Shpenzime jetike sipas ILDKPKI-së	654,546	654,546
	Diferenca		-705,342	272,717

38.13 Nga hetimi i kryer dhe analiza financiare, Komisioni ka konstatuar se:

- i. Subjekti nuk ka pasur mundësinë e krijimit të të ardhurave në shumën prej 100.000 lekësh, që kanë shërbyer për blerjen e automjetit në vitin 2004 në shumën prej 300.000 lekësh, si dhe nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për të krijuar gjendjen e likuiditeteve (në *cash* dhe në bankë) në fund të vitit 2004.
- ii. Subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e gjendjes *cash* 500.000 lekë në fund të vitit 2004, për shlyerjen e shumës 503.000 lekë, në shkurt të vitit 2005, shumë të cilën subjekti e ka deklaruar se përfaqëson zhdoganimin dhe rregullime të tjera të automjetit.

38.14 Pas kalimit të barrës së provës, mbi këto konstatime, subjekti ka dhënë të njëjtat shpjegime si në deklaratimet e pyetësorëve të cituar më sipër në arsyetim.

39. Vlera monetare në *cash*, në shumën 7.000 euro dhe 400.000 lekë.

39.1 Burimi i deklaruar i krijimit:

- ✓ Shitja e autoveturës, me targë ***, nga subjekti i rivlerësimit tek shtetasi Ç.K., në shumën 5.000 euro.
- ✓ Kursimi një vjeçar.
- ✓ Diferenca nga kredia që nuk i ka dhënë vajzës së tij J.D.

39.2 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente³².

³² Kontratë shitje pasurie e luajtshme, nr. ***, datë 25.08.2016.

39.3 Konkluzioni i ILDKPKI-së:

- i. Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e ardhur nga DPPP-jë. Tërheqja është kryer pranë “Credins Bank”, pasi përputhet dhe me dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti (nxjerrje llogarie) dhe përputhet numri i llogarisë ***.

39.4 Hetimi i kryer nga Komisioni³³

Analiza e provave:

39.4.1 Me kontratën e shitjes nr. ***, datë 25.08.2016, rezulton se është shitur automjeti, me targë ***, në shumën 5.000 euro³⁴.

39.4.2 Subjekti është pyetur në lidhje me gjendjen e likuiditeteve në *cash* në fund të çdo viti.

39.4.3 Pranë “Credins Bank” në llogarinë bankare të z. Hysni Demiraj, më datë 08.04.2016, është disbursuar kredia bankare në shumën 20.000 euro, nga të cilat:

- Më datë 22.04.2016, me urdhër xhirim të brendshëm është kaluar shuma 5.000 euro me përfituese znj. J.D.
- Më datë 03.06.2016, me urdhër xhirim të brendshëm është kaluar shuma 4.950 euro me përfituese znj. J.D. (gjithsej 9.950 euro).
- Më datë 03.06.2016, subjekti ka tërhequr *cash* shumën 10.000 euro.

39.4.5 Nga të dhënat e lartpërmendura, Komisioni, ka kryer analizën financiare të likuiditeteve pasqyruar në tabelën më poshtë.

Nr.	Gjendja e llogarive bankare sipas bankave	2015	2016
2	“Raiffeisen Bank”		
	I.D., llogari page	-103	
3	“BKT”		
	I.D., nr. ***		7,122
4	“Veneto Banka”		
	J.D., nr. ***		0
5	“Banka Credins”		
	Hysni Demiraj, llogari page nr. ***	1,046	1,442
	Hysni Demiraj llog. rrjedhëse në euro		6,899
	J.H.D.		964,648
6	“Banca Popolare di Sondrio”, Milano		145,379

Kontratë kredi bankare, nr. ***, datë 08.04.2016.

Vërtetim nr. ***, datë 20.10.2017, nga “Credins Bank”.

³³Shkresë nr. *** prot., datë 18.01.2018, dërguar Bankës së Shqipërisë, dhe të gjitha bankave të nivelit të dytë si dhe institucioneve jobankare. Me shkresën nr. *** prot., datë 13.03.2018, “Credins Bank” ka konfirmuar; Llogari page në emër të z. Hysni Demiraj si dhe llogari rrjedhëse në euro; Llogari rrjedhëse në emër të znj. J.D.

³⁴ Shih, aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së.

	Gjendja <i>CASH</i>	700,000	1,346,890
	TOTALI	700,943	2,472,379

39.5 Konstatohet se subjekti ka pasur të ardhura për krijimin e gjendjes *cash* në shumën 7.000 euro dhe 400.000 lekë.

40. Kredi konsumatore studimi afatgjatë, datë 07.04.2016, pranë “Credins Bank”, në shumën 20.000 euro. Subjekti ka deklaruar se pjesa e papaguar e detyrimit është në shumën 19.248,22 euro.

40.1. Hetimi i kryer nga Komisioni³⁵

Analiza e provave:

40.1.1 Nga aktet rezulton se kredia në shumën 20.000 euro është përfituar me kontratën nr. ***, datë 07.04.2016, noterizuar me kontratën, nr. ***, disbursuar, më datë 08.04.2016, me afat shlyerje 15 vite, me interes *Libor euro* dhe 4.82 % (pjesë e pandryshueshme e normës së interesit).

40.1.2 Më datë 22.04.2016, përfitueses së saj/kredisë, personit të lidhur, vajzës së subjektit, J.D., me urdhër xhirim të brendshëm i ka kaluar shuma 5.000 euro. Më datë 03.06.2016 me urdhër xhirim të brendshëm i ka kaluar shuma 4.950 euro, pra gjithsej i ka kaluar shuma 9.950 euro. Ndërsa, më datë 03.06.2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka tërhequr *cash* shumën 10.000 euro.

40.1.3 Gjatë verifikimit të shlyerjes së kredisë në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit u konstatua se derdhjet e kësteve kryheshin nga shtetasja H.S.

40.1.4 Për një hetim të plotë, lidhur me veprimet bankare të kryera nga një person i tretë, është pyetur subjekti i cili ka dhënë deklaratimet përkatëse³⁶.

40.1.5 Subjekti është pyetur edhe lidhur me shpenzimet e kryera nga vajza e tij e cila ka përfituar kredinë për qëllime studimi, nga ku ka dhënë shpjegimet përkatëse³⁷, si dhe ka vënë në dispozicion disa dokumente³⁸.

³⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 18.01.2018, drejtuar Bankës së Shqipërisë, dhe të gjitha bankave të nivelit të dytë si dhe institucioneve jobankare.

Me shkresën nr. *** prot., datë 13.03.2018, “Credins Bank” ka konfirmuar: Disbursimin e kredisë, më datë 08.04.2016, në emër të z. Hysni Demiraj, në shumën 20.000 euro.

Shkresë nr. *** prot., datë 25.01.2018, drejtuar Zyrës së Regjistrimit Noterial.

Me shkresën nr. *** prot., datë 12.02.2018, Zyra e Regjistrimit Noterial, ka konfirmuar kontratën e kredisë më datë 08.04.2016.

³⁶ Shih përgjigjen e pyetjes nr.1 (ardhur, më datë 13.11.2018) të pyetësorit nr. 3, datë 06.11.2018, në dosjen e Komisionit.

³⁷ Shih përgjigjen e pyetjes nr. 2 (ardhur, në datë 13.11.2018) të pyetësorit nr. 3, datë 06.11.2018, në dosjen e Komisionit.

³⁸ Certifikatë Bocconi, 2018 – ***, ID e studentit ***, pagesa totale për vitin 2016, lëshuar, më datë 8.11.2018 (5 fletë).

Certifikatë Bocconi, 2018 – ***, ID e studentit ***, pagesa totale për vitin 2016, lëshuar, më datë 8.11.2018 (5 fletë).

Vërtetim nga shoqëria “****” mbi shpenzimet e bëra nga personi i lidhur, vajza e subjektit, për udhëtimet e bëra përkatësisht në vitin 2016 dhe 2017, ku citohet se disa prej biletave janë studentore (2 fletë).

Certifikatë Bocconi, 2018 – ***, ID e studentit ***, pagesa totale për vitin 2018, lëshuar, më datë 16.11.2018 (5 fletë).

40.1.6 Nga aktet rezulton se personi i lidhur i subjektit, vajza e subjektit, J.D., ka deklaruar depozitë bankare në Milano, përfituar nga kredia e babait të saj, subjekt rivlerësimi. Me transferta ajo ka marrë shumën 6.050 euro nga “Veneto Banka”, më datë 07.10.2016, dhe shumën 7.070 euro, më datë 10.01.2017, nga “Credins Bank”. Gjithashtu, ka deklaruar shumën 17.000 euro të kaluar nga babai i saj. Nga “Banca Popolare di Sondrio” është dhënë informacion për gjendjen e llogarisë në shumën 8.144, 73 euro, më datë 17.01.2017, duke përfshirë edhe transfertën e kryer nga “Credins Bank”, më datë 10.01.2017, në shumën 7.070 euro, të cilat janë në bankën Italiane “Banca Popolare di Sondrio” në Milano, Itali, në emrin e saj. Vajza e subjektit ka deklaruar se deri në datën e nënshkrimit të deklaratës ka kryer shtatë pagesa të ndryshme në shumën 8.425, 27 euro, ku shuma prej 8.126, 80 eurosh i përket pagesës së shkollës.

40.1.7 Komisioni mbi të dhënat e lartpërmendura ka kryer analizën financiare e cila pasqyrohet në tabelën më poshtë.

Pasqyra financiare e vitit 2016

Nr.	Përshkrimi	2016
	Pasuritë	1,771,436
1	LIKUIDITETE	1,771,436
	Të ardhurat	2,281,752
1	Të ardhura nga paga	1,562,283
2	Paga e bashkëshortes	43,119
3	Shitja e automjetit, tip “Mercedes Benz” (5.000 euro)	676,350
	Detyrimet	2,547,473
1	Kredi bankare në “Credins Bank”	2,705,400
2	Shlyer këstet e kredisë “Credins Bank”	-157,927
	Shpenzime	2,079,596
1	Për shkollimin e vajzës në Milano, Itali	1,139,686
2	Shpenzime shkolle për djalën D.D.	27,054
8	Shpenzime jetike	654,548
9	Për udhëtime jashtë shtetit	258,308
	Diferenca	978,193

✓ **Konstatohet se deklaratimet e subjektit përputhen me provat e administruara.**

Përmbledhëse të shpenzimeve universitare si libra, pagesa, transferta, etj. për vitin 2016, 2017 dhe 2018, (3 fletë).
Bilanci dhe lista e lëvizjeve bankare në emër të personit të lidhur, vajzës së subjektit të rivlerësimit, në Bankën Popullore Sondrio, Itali, (10 fletë).

Dokumente, ku përfshihet certifikata 2016 – *** e Universitetit Bocconi, etj, lëshuar më datë 23.11.2018, të cilët pasqyrojnë nisjen e studimeve në datë 24.06.2016, vijimin si dhe shpenzimet për akomodim në vitin 2016, të personit të lidhur, vajzës së subjektit të rivlerësimit (3 fletë).

Dokumente, ku përfshihet certifikata 2016 – *** e Universitetit Bocconi, etj, lëshuar më datë 22.11.2018, të cilët pasqyrojnë nisjen e studimeve, më datë 24.06.2016, vijimin si dhe shpenzimet për akomodim në vitin 2017, të personit të lidhur, vajzës së subjektit të rivlerësimit (3 fletë).

41. Kredi *overdrafti* pranë “Credins Bank”, datë 07.04.2016, në shumën 1.000.000 lekë me afat 24 muaj, e kaluar në kartë “visa”, shumë e paprekur deri ditën e dorëzimit të deklaratës.

41.1 Komisioni kreu hetim³⁹ për këtë kredi.

41.2 Konstatohet se deklaratimet e subjektit përputhen me dokumentin bankar.

Gjendja financiare e subjektit të rivlerësimit prej deklaramit për herë të parë e deri në vitin 2016.

Viti	Të ardhurat	Pasuritë	Detyrimet	Shpenzimet	Diferenca
2003	748,712	50,000	0	562,900	135,812
2004	1,103,848	1,082,644	0	726,546	-705,342
2005	1,031,168	31,905	0	726,546	272,717
2006	1,445,560	5,170,089	5,000,000	747,546	527,925
2007	1,387,749	-192,828	-600,000	744,546	126,031
2008	1,269,889	32,880	-600,000	736,546	-194,537
2009	1,526,208	1,156,083	582,120	694,546	177,699
2010	1,230,284	-396,476	-1,155,240	658,546	-250,112
2011	1,207,359	-3,998	-576,600	807,186	-229,929
2012	1,223,403	-886	-569,860	658,546	-49,117
2013	1,322,399	3,702,528	2,925,880	700,609	-174,858
2014	1,315,899	-2,557	-500,000	831,876	-20,920
2015	1,325,842	-1,412	-575,300	872,858	-120,904
2016	1,605,402	968,436	2,615,077	2,273,850	978,192
TOTALI	17,743,722	11,596,407	6,546,077	11,742,647	950,744

41.3 Konkluzione mbi vlerësimin e pasurisë.

41.4 Komisioni, pasi shqyrtoi dokumentacionin e grumbulluar nga hetimi administrativ, si dhe provat e shpjegimet e paraqitura nga subjekti, në përfundim të vlerësimit të kriterit pasuror për këtë subjekt, konstaton se:

- i. Subjekti ka kryer deklaramit të pasaktë për sa i përket vlerës së paguar për m², për blerjen e pasurisë apartament banimi, përshkruar si pasuria 1.
- ii. Ka mospërputhje midis deklaramit të bërë në deklaratën “Vetting” dhe deklaratën për vitin 2013, për pasurinë garazh, me sip. 29.2 m², me deklaramin e bërë në vitin 2010, me sip. 15 m².
- iii. Subjekti ka kryer deklaramit të pasaktë në lidhje me shumën e shpenzuar për blerjen e pasurisë garazh, pasi ka deklaramit nga viti 2010 deri në vitin 2012 shumën 12.500 euro, ndërsa në vitin 2013 ka deklaramit shumën 8.000 euro.

³⁹Shkresë nr. ***prot., datë 18.01.2018, drejtuar Bankës së Shqipërisë, dhe të gjitha bankave të nivelit të dytë si dhe institucioneve jobankare. Me shkresë nr. *** prot., datë 13.03.2018, “Credins Bank” e ka konfirmuar këtë kredi të paprekur.

- iv. Subjekti është trajtuar me çmim preferencial në blerjen e pasurive, në raport me shtetas/blerës të tjerë, pasi është provuar ekzistenca e konfliktit të tij të interesit në gjykimin e një çështjeje civile dhe për pasojë edhe marrëdhëniet kontraktore të blerjes së pasurive çmohen fiktive.
- v. Personi tjetër i lidhur i subjektit të rivlerësimit, shtetasi P.K., nuk justifikon me burime të ligjshme huan e dhënë në shumën prej 5.000.000 lekësh.
- vi. Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për shlyerjen e kësteve të huas në shumën prej 5.000.000 lekësh, vit pas viti.
- vii. Vëllai i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e personit tjetër të lidhur, nuk justifikon me burime të ligjshme huan e dhënë në shumën 30.000 euro.
- viii. Subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pagesën e parë të shumës 2.000 euro, nga huaja e marrë në shumën 30.000 euro, nga personi tjetër i lidhur, vëllai i subjektit, në vitin 2013.
- ix. Subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e bërë për blerjen e automjetit në vitin 2004, zhdoganuar në vitin 2005.
- x. Subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e gjendjes *cash* (500.000 lekë) në fund të vitit 2004, për shlyerjen e shumës 503.000 lekë, në shkurt 2005, shumë të cilën subjekti e ka deklaruar se përfaqëson zhdoganimin dhe rregullime të tjera të automjetit.

41.5 Pra, mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimeve, si dhe provat shkresore të administruara në dosje, lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit:

- ✓ *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- ✓ *ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm.*

B. KONTROLLI I FIGURËS

42. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, ajo ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar: "*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit z. Hysni Demiraj*". Ky raport është deklasifikuar⁴⁰ më datë 28.03.2018.

43.. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Konkluzione për vlerësimin e kontrollit të figurës.

44. Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta.

⁴⁰ Vendim nr. ***, datë 28.03.2018.

45. Trupi gjykues vlerëson se, subjekti i rivlerësimit, z. Hysni Demiraj, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

46. Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD), ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar tre dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dosjeve, të përzgjedhura me short, sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me *** prot., datë 26.04.2018. Nga ky institucion, është konfirmuar se:

- a. Subjekti i rivlerësimit, z. Hysni Demiraj, më datë 06.07.1995, është emëruar gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.
- b. Më datë 12.06.2009, është emëruar gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë ku vazhdon aktualisht.
- c. Prej datës 07.03.2016, subjekti ushtron funksionin e kryetarit të Gjykatës së Apelit Tiranë.
- d. Për periudhën 03.02.2006 - 06.05.2011, gjyqtari Hysni Demiraj, ka qenë anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare.
- e. Subjekti ka deklaruar se në tre vitet e fundit i janë caktuar gjithsej 1127 çështje gjyqësore. Ai ka përfunduar gjithsej 1088 çështje gjyqësore me cilësinë e relatorit. Në vitin 2016 ka mbartur 3 çështje gjyqësore.
- f. Subjekti ka deklaruar se nuk ka specializime.
- g. Subjekti ka deklaruar 8 trajnime pranë Shkollës së Magjistraturës.
- h. Subjekti nuk ka deklaruar trajnime jashtë Shkollës së Magjistraturës për tre vitet e fundit, por ka deklaruar pjesëmarrje në trajnime prej periudhës jashtë rivlerësimit që i përket periudhës 1996 - maj 2013 nga ku është pajisur me 17 certifikata trajnimi.
- i. Subjekti ka përzgjedhur dhe ka paraqitur tre dokumente ligjorë, të llojit vendim gjyqësor, të cilat janë përshkruar në këtë raport duke u evidentuar mangësitë dhe shkeljet e mundshme ligjore.
- j. Nuk ka të dhëna nga burime arkivore të KLD-së për subjektin e rivlerësimit, z. Hysni Demiraj.

47. Konkluzion: KLD-ja pasi ka evidentuar disa të meta për subjektin e rivlerësimit duke i përmendur dhe analizuar ato rast pas rasti, ka vlerësuar se subjekti ka treguar aftësi profesionale, organizative, etike dhe angazhim ndaj vlerave profesionale.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLD-SË

48. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Hysni Demiraj janë paraqitur gjithsej 9 ankesa në Inspektoratin e KLD-së (2 ankesa në vitin 2014, 3 ankesa në vitin 2015 dhe 4 ankesa në vitin 2016).

49. Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Hysni Demiraj përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

ANALIZA E GJETJEVE

50. Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tre grupet e burimeve të informacionit:

- i. formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti;
- ii. pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe
- iii. të dhënat nga burimet arkivore në KLD.

51. Në lidhje me aftësitë profesionale:

51.1 Njohuri ligjore

51.1.1 Njeh parimet e përgjithshme të së drejtës së procesit të rregullt ligjor dhe i zbaton ato në praktikë. I kushton rëndësi cilësisë së hetimit gjyqësor të zhvilluar në shkallë të parë. Subjekti evidenton edhe lidhje që çështje të ligjit të mosmarrëveshjes konkrete kanë me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe me jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë (referuar dokumentit 3).

51.2 Arsyetimi ligjor.

51.2.1 Vendimet e subjektit janë të thjeshta, të arsyeshme dhe të kuptueshme. Në përgjithësi respektohen rregullat e drejtshkrimit, por nuk përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Përgjithësisht, struktura e vendimit përmban elementët e kërkuar nga legjislacioni penal e civil, ndërsa tek pjesa arsyetuese jep në mënyrë të ndarë faktin e mosmarrëveshjes nga analiza ligjore.

- Në analizën ligjore vërehet tendenca e dhënies së argumentit ligjor me fjali konkluduese, ndërsa në ndonjë rast teksti mbi faktet jepet i zgjatur apo me përsëritje (referuar dokumentit 2 dhe 3).
- Në ndonjë rast, niveli i arsyetimit ligjor nuk ka lidhjen e duhur me bazën ligjore dhe jurisprudenciale të referuar nga gjyqtari (referuar dokumenteve 2 dhe 3).
- Nevojitet kushtim sa i përket rëndësisë së identifikimit të normës ligjore konkrete mbi të cilën analizohen pretendimet konkrete të palëve.
- Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari.
- Në nxjerrjen e konkluzioneve subjekti përdor fjali të përgjithshme dhe të arsyeshme, pa treguar bazën ligjore ku mbështetet analiza dhe konkluzioni.
- Në një rast është konstatuar se pjesa hyrëse është e paplotë, ndërsa jepen detaje mbi shkaqet e rekursit nuk pasqyrohen se çfarë ka vendosur Gjykata e Lartë dhe cilat kanë qenë detyrat që kjo gjykatë ka lënë për rigjykimin e çështjes në Apel (referuar dokumentit 1).
- Në ndonjë rast në dispozitivin e vendimit nuk shënohet e drejta e rekursit të palëve (referuar dokumentit 3 dhe 5).

52. Në lidhje me aftësitë organizative:

52.1 Subjekti është efektiv në punë, ka pasur ngarkesë mbi standardin minimal duke mbajtur parasysh edhe faktin se në pozicionin e kryetarit të një gjykate puna minimale e tij është në

standardin 40 % të ngarkesës së një gjyqtari të gjykatës. Subjekti ka respektuar afatin 5 ditor në rastin e zbardhjes së vendimeve penale dhe 10 ditë të atyre civile.

52.2 Subjekti ka aftësi për të kryer procedurat ligjore. Dosjet e vëzhguara penale janë vënë në lëvizje pa vonesa prej tij (referuar dosjes 1 dhe 2).

53. Në lidhje me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale.

- a) Nuk ka të dhëna në lidhje me mungesën e integritetit.
- b) Nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit.
- c) Nuk janë konstatuar raste që subjekti nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.

54. Në lidhje me aftësitë personale dhe angazhimin profesional.

54.1 Aftësia e kotmunikimi

54.1.1 Përgjithësisht në dosjet e kontrolluara është konstatuar se komunikimi ka qenë i qartë dhe i rregullt. Është konstatuar se gjuha e përdorur në seancë është normale dhe komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore.

54.2 Aftësia për të bashkëpunuar

54.2.1 Nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar. Nuk janë konstatuar vonesa në arsyetimin e vendimeve gjyqësore. Subjekti ka bashkëpunuar me trupin gjykues dhe administratën gjyqësore për të zhvilluar seancat sipas rregullave procedurale.

54.3 Gatishmëria për t'u angazhuar

54.3.1 Subjekti ka pasur detyrimin për t'iu nënshtruar formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Subjekti ka marrë pjesë dhe është certifikuar në tetë seminarë të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës. Subjekti në këtë këndvështrim rezulton të ketë marrë pjesë në 12 ditë të formimit vazhdues për një periudhë tre vjeçare, kryesisht në tema që lidhen me detyrën e gjyqtarit por jo specifikisht me detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit.

55. Nga pikëpamja formale dhe procedurale, Komisioni, ka vërejtur se në dosje kryesisht:

- Nuk ka akt formal të gjyqtarit relator për kalimin e çështjeve në seancë gjyqësore;
- Nuk ka relacion me shkrim nga relatori i çështjes, në fashikull;
- Nuk përfshihet kopje e listës së shpalljes së seancave gjyqësore për të dokumentuar datën e njoftimit, ndonëse asnjë seancë nuk ka dështuar për këtë shkak.
- Seancat gjyqësore janë zhvilluar në sallë gjykimi, por nuk është konstatuar në asnjë rast që ato të jenë dokumentuar me regjistrim audio, në funksion të transparencës dhe solemnitetit.

56. Sipas ndarjes së dosjeve të përzgjedhura nga vetë subjekti dhe ato me short, është vërejtur:

56.1 Në dokumentin ***, që i përket vendimit nr. ***, datë 16.07.2012, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, **në dokumentin *****, që i përket çështjes civile me objekt: “Detyrimin e të

paditurit t'i shpërblejë paditësit dëmin jopasuror në shumën 7.000.000 lekë”, si dhe në dokumentin ***, janë konstatuar të njëjtat problematika si edhe në raportin e KLD-së.

56.2Në pesë dosjet e përzgjedhura me short, në tërësi janë konstatuar gjetjet si më poshtë vijon:

- Mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të.
- Mungesë e akteve për caktimin e seancës gjyqësore në dosje. Ky fakt thuhet është i përsëritur në të gjithë dosjet.
- Mungesë e relacionit me shkrim nga relatori i çështjes sipas nenit 464 të Kodit të Procedurës Civile. Ky fakt thuhet është i përsëritur në të gjithë dosjet.
- Ka raste ku nuk tregohet e drejta e rekursit të palëve (referuar dokumentit 3 dhe 5).
- Arsyetimi është i orientuar drejt paraqitjes së fakteve, me fjali të përgjithshme konkluduese.
- Normat ligjore të referuara në pjesën arsyetuese janë të natyrës së përgjithshme dhe nuk lidhen drejtpërdrejt me pretendimet e ngritura nga ankuesi.
- Paraqitja e fakteve, sidomos paraqitja e arsytimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, është e tejzgjatur në raport me analizën ligjore të vetë Gjykatës së Apelit.
- Analiza ligjore e Gjykatës së Apelit ka formën e konkluzioneve. Pjesa e parë e kësaj analize përbëhet nga tregimi i normave ligjore me natyrë të përgjithshme, që nuk lidhen drejtpërdrejt me pretendimet e ngritura nga ankuesi.
- Ndonëse në pjesën hyrëse të vendimit nr. ***, datë 27.11.2014 (referuar dokumentit 4), janë listuar pretendime konkrete që lidhen me cilësinë e dy provave të cituara me attribute, në pjesën arsyetuese të vendimit të Gjykatës së Apelit, këtyre pretendimeve iu është dhënë përgjigje me konkluzione të përgjithshme.
- Përgjithësisht janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, por nuk përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe.
- Në analizën ligjore vërehet tendenca e dhënies së argumentit ligjor me fjali konkluduese.
- Referuar dokumentit ***, është konstatuar se pjesa hyrëse është e paplotë, ndërsa jepen detaje mbi shkaqet e rekursit nuk pasqyrohet se çfarë ka vendosur Gjykata e Lartë dhe cilat kanë qenë detyrat që kjo gjykatë ka lënë për rigjykimin e çështjes në Gjykatën e Apelit.
- Referuar dokumentit ***dhe ***, niveli i arsytimit ligjor nuk ka lidhjen e duhur me bazën ligjore dhe jurisprudenciale të referuar nga gjyqtari.
- Nevojitet kushtim sa i përket rëndësisë së identifikimit të normës ligjore konkrete mbi të cilën analizohen pretendimet konkrete të palëve.
- Në nxjerrjen e konkluzioneve subjekti përdor fjali të përgjithshme dhe të arsyeshme, pa treguar bazën ligjore ku mbështetet analiza dhe konkluzioni.

57. Pas këtyre konstatimeve, subjektit iu kërkua të japë shpjegime. Në tërësi në parashtrimet e tij subjekti ka pranuar se; në raste të pakta është cenuar cilësia e arsytimit të vendimit; në disa fjalë nuk janë përdorur të gjitha rekordet e gjuhës shqipe, pasi drejtshkrimi i saktë dhe përdorimi i duhur i shenjave të pikësimit është kërkesë themelore për të përfutur shkrim cilësor; neni 464 i Kodit të Procedurës Civile nuk e kërkon relacion me shkrim, etj.

58. Konkluzione:

- i. Në analizë të parashtrimeve të subjektit, Komisioni, konstaton se gjetjet janë të drejta dhe të bazuara.
- ii. Rastet kur nuk tregohet e drejta e ankimit për palën në proces gjyqësor, mungesa e akteve për kalimin e çështjes në seancë, etj., janë evidente dhe kanë rezultuar të përsëritura në pesë dosje të kontrolluara.
- iii. Subjekti i rivlerësimit nuk ka zbatuar nenin 115 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, nenin 118 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe parashikimet e kreut II të Udhëzimit nr. 353, datë 03.09.2013, të KLD-së “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio”. Në vendimin unifikues nr. 1, datë 27.04.2015, Kolegjet e Bashkuara kanë arritur në përfundimin se mbajtja e procesverbalit të seancës gjyqësore nëpërmjet regjistrimit audio dhe audioviziv, është jo vetëm në përputhje me nenin 115 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, por duke u parashikuar prej tij si një nga mjetet e mbajtjes së procesverbalit, rrit efektivitetin, eficiencën dhe garanton transparencën në seancat gjyqësore duke përmbushur në mënyrë shteruese dhe autonome funksionin dokumentues të veprimeve procedurale.
- iv. Mungesa e relacioneve në dosjet e gjykuara bie në kundërshtim me nenin 464 të Kodit të Procedurës Civile. Një lexim i kujdesshëm i dispozitës ligjore, “*seanca gjyqësore fillon me relacionin e njërit prej anëtarit të trupës gjyqësore*”, nënkupton përgatitjen e aktit. Kjo qasje është e njëjtë me dispozitën e parashikuar në nenin 49, të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar. Dispozitat nuk konfundojnë njëra-tjetrën, pasi në të dy rastet përmendet “akti” dhe jo “relatimi”. Përtej praktikave të krijuara, legjislati miratohet për t’u zbatuar në formën e kërkuar.

C/1 ÇËSHTJE TË TRAJTUARA KRYESISHT NGA KOMISIONI

59. Çështja gjyqësore civile, e trajtuar kryesisht nga Komisioni, që i përket vendimit nr. *, datë 27.03.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. ***, datë 08.02.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë.**

Lidhur me këtë çështje, Gjykata e Apelit Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 17.09.2018, ka vënë në dispozicion vendimin e lartpërmendur.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vënë në dispozicion dosjen e plotë që i përket palëve ndërgjyqëse:

Paditës: M.L.

Të Paditur: M.D., etj.,

Objekti: Detyrimin e të paditurve M.D., V.D., F.S., H.S. dhe F.Ll., për t’i kthyer bashkërisht paditësit M.L. shumat si vijojnë: 14.700 USD; 12.000 euro; 400.000 lekë dhe 180.000 lekë si dhe interesat bankare mbi këto shuma deri në ditën e kryerjes së ekspertimit gjyqësor...

59.1 Çështja është gjykuar në Gjykatën e Apelit Tiranë nga trupi gjyqësor, ku bën pjesë me cilësinë e anëtarit, edhe subjekti i rivlerësimit.

59.2 Komisioni, gjatë hetimit administrativ të kriterit të rivlerësimit të pasurisë, ka krijuar dyshime të arsyeshme mbi gjendjen e konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit lidhur me shqyrtimin e kësaj çështjeje gjyqësore në raport me deklarin e bërë prej tij për pasurinë nr. ***, *apartment*

*banimi, me sip. 141.4 m² dhe pasurinë nr. ***, garazh, me sip. 29.2 m², në Tiranë, porositur pranë shoqërisë “***” sh.p.k. me përfaqësues ligjor, znj. V.D.*

59.3 Trajtimi i çështjes është vlerësuar në përputhje me legjislacionin procedural civil dhe atë të konfliktit të interesit.

59.4 Rrethanat e çështjes:

59.4.1 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin e saj nr. ***, datë 27.03.2012, që i përket palëve ndërgjyqëse të lartpërmendura, ka vendosur:

- Pranimin pjesërisht të padisë, duke detyruar të paditurit M.D., V.D., etj, për t'i kthyer bashkërisht paditësit M.L. shumën prej 14.700 USD si dhe interesat ligjore mbi këtë shumë sipas kriterit të depozitave me afat të Bankës së Shqipërisë; interesa ligjore që sipas aktit të ekspertimit gjyqësor deri në datën e kryerjes së këtij ekspertimi, më datë 27.10.2012, kapin vlerën prej 3.106 USD.
- Rrëzimin për pjesën tjetër të mbetur të padisë, që lidhet me kthimin e shumave tej limitit të sipërcituar në këtë dispozitiv vendimi si dhe për pjesën e padisë të ngritur ndaj të paditurve: M.D., F.S. dhe F.LI., si të pabazuar në prova e ligj...

59.5 Vendimi është ankimuar nga pala e paditur, më datë 12.04.2012, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe është regjistruar në sistem me nr. ***.

59.6 Trupi gjykues i Gjykatës së Apelit Tiranë, i përbërë nga znj. Z.S., me cilësinë e kryesueses, subjekti i rivlerësimit, z. Hysni Demiraj, në cilësinë e relatorit dhe z. D.B. me cilësinë e anëtarit, me vendimin e tij nr. ***, datë **08.02.2013**, ka vendosur:

“Ndryshimin e vendimit nr. *** , datë 27.03.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rrëzimin e kërkesë - padisë së paditësit M.L. si të pabazuar.”

59.7 Çështja rezulton të jetë rekursuar në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin e saj nr. ***, datë 12.10.2016, ka vendosur: “*Mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala paditëse, kundër vendimit nr. ***, datë 08.02.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë*”.

59.8 Gjatë hetimit administrativ në kriterin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ky i fundit ka deklaruar: “*Pasurinë nr. ***, apartament banimi, me sip. 141.4 m² dhe pasurinë me nr. ***, garazh, me sip. 29.2 m², në Tiranë, porositur pranë shoqërisë “***” sh.p.k., me përfaqësues ligjor, znj. V.D.*

59.9 Në deklaratën për vitin 2007, subjekti ka deklaruar se ka lidhur një kontratë sipërmarrjeje me shoqërinë “***” sh.p.k., për një apartament 3+1, për të cilin janë paguar dy këste në vlerën 20.000 euro.

59.10 Në deklaratën për vitin 2009, subjekti ka deklaruar kontratë sipërmarrjeje me shoqërinë “***” sh.p.k., për ndërtimin e një garazhi (pa sipërfaqe) në pallatin ku jeton.

59.11 Në vitin 2013, subjekti i rivlerësimit, ka lidhur kontratën e shitjes nr. ***, datë 15.07.2013, për blerjen e apartamentit me sip. 141.4 m², në shumën 65.751 euro, dhe blerjen e garazhit me kontratën nr. ***, datë 15.07.2013, në shumën 8.000 euro me sip. 29.2 m².

59.12 Subjekti i rivlerësimit në rastin objekt gjykimi është njohur me padinë dhe palët ndërgjyqëse, ndër të cilët rezultojnë edhe shtetasit M.D. dhe V.D. Këta shtetas në marrëdhënie me subjektin kanë cilësinë e përfaqësuesve/administratorë të shoqërisë ndërtuese, ku subjekti ka bërë porosinë e pasurive dhe ka finalizuar blerjet e tyre.

59.13 Me procesverbalin e seancës gjyqësore, datë 08.02.2013, është konfirmuar pjesëmarrja e palëve në proces dhe njëkohësisht dakordësia e palëve me trupin gjykues.

59.14 Pas këtyre konstatimeve, është pyetur subjekti i rivlerësimit, nga ku ka deklaruar⁴¹ se: *"...Gjatë karrierës sime si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë si dhe si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë nuk kam gjykuar asnjë çështje civile apo penale ku të ketë qenë palë shoqëria ndërtimore "***" sh.p.k. Pas verifikimit të bërë në arshivën e gjykatës me rezulton se në vitin 2013 kam qenë në trup gjykues të përbërë prej relatorit dhe kryesuesit Z.S. me anëtar D.B. dhe Hysni Demiraj ku si palë e paditur në proces kanë qenë përfaqësuesja e shoqërisë ku unë kam pasur kontratën e sipërmarrjes, znj.V.D., bashkëshorti i saj M.D. si dhe bashkë të paditurit F.S., H.S. dhe F.Ll. të paditur nga paditësi M.L., me objekt: detyrim për kthim shumash. Numri i vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë është nr. ***, datë 08.02.2013, nr. regjistri ***."*

59.15 Në vijim në deklaratimet e tij në pyetësor, p.sh për huadhënësin, z. P.K., subjekti ka deklaruar se:⁴² *"... unë kam një njohje me shtetasin P.K. që në vitin 1996 ...pasi ky shtetas ishte mik me familjen e bashkëshortes, ai vete, babai i tij, si dhe ...Gjatë gjithë kohës që kam ushtruar detyrën e gjyqtarit nuk kam gjykuar asnjë çështje ku ka qenë palë apo ka pasur interesa ky shtetas, kjo pasi më pengon neni 72 pika 3 të Kodit të Procedurës Civile"*.

59.16 Subjekti ka prezantuar edhe një rast tjetër gjyqësor ku ai ka qenë në cilësinë e relatorit në Gjykatën e Apelit Tiranë. Subjekti ka sqaruar se, pasi është njohur me palët ndërgjyqëse, është shprehur se nuk mund të gjykonte këtë proces gjyqësor, pasi ka njohje me paditësen E.S... pasi ka jetuar tetë vjet në banesën e tyre dhe më tej ka hequr dorë nga gjykimi i kësaj çështje duke cituar se kërkesa do t'i paraqitet titullarit të gjykatës. Për këtë rast, në procesverbalin e radhës, datë 04.03.2014, pasqyrohet përbërja e re e trupës gjyqësore, nga ku rezulton se subjekti i rivlerësimit është zëvendësuar me një tjetër gjyqtar.

59.17 Duke iu referuar fakteve dhe rrethanave të konstatuara në çështjen objekt gjykimi, si dhe deklaratimeve të subjektit në pyetësor, konstatohet se subjekti ka mbajtur dy qëndrime të kundërta në shqyrtimin e proceseve gjyqësore. Në ndryshim nga qëndrimi i mbajtur në procesin civil ku ka kërkuar dorëheqjen me arsyetimin se si palë kanë qenë shtetas tek të cilët ai ka pasur marrëdhënie qiraje, në këtë proces civil, subjekti nuk ka kryer të njëjtin veprim, por ka shqyrtuar dhe është shprehur me vendimmarrje.

⁴¹ Referojuni përgjigjeve të dhëna në pyetësorin, datë 07.09.2018, në dosjen e Komisionit.

⁴² Referojuni përgjigjeve të pyetësorit, datë 07.09.2018, në dosjen e Komisionit.

59.18 Vërehet se çështja e gjykuar dhe përfunduar me vendimmarrjen e lartpërmendur, në objekt të saj ka pasur konfliktin mes palëve ndërgjyqëse, për pasuri të cilat janë ndërtuar nga shoqëri të palës së paditur.

59.19 Nga aktet e depozituara lidhur me rivlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ndërthurur me aktet e dosjes gjyqësore dhe veprimet e kryera për llogari të procesit gjyqësor, konstatohet se:

59.19.1 Subjekti i rivlerësimit ka hyrë në marrëdhënie me shtetasit D. që prej vitit 2007, kohë në të cilën ai ka porositur pasurinë apartament në shoqërinë e përfaqësuar prej tyre. Në këtë proces civil këta shtetas rezultojnë të jenë palë ndërgjyqëse. Marrëdhënia me këta shtetas e nisur prej vitit 2007 me porosinë e apartamentit me sip. 159.5 m², në shumën 65.751 euro, ka vijuar në mënyrë konsistente, në vitin 2009 me porosinë e garazhit, në vitin 2010, 2011 dhe 2012 me pagimin e kësteve të garazhit dhe në korrikun e vitit 2013 me shlyerjen përfundimtare të pagesës së dy pasurive.

59.19.2 Subjekti ka finalizuar përfitimn e pasurisë së tij në korrik të vitit 2013, ndërsa ka gjykuar dhe është shprehur me vendim gjyqësor në shkurt të po këtij viti, në favor të njërës prej palëve ndërgjyqëse, që në linjë të drejtë janë përfaqësuesit e shoqërisë ndërtimore “****” sh.p.k.

59.20. Nën këto argumente, Komisioni, çmon se:

59.20.1 Subjekti me të rënë në dijeni të faktit se procesi civil do të zhvillohej nga një trup gjykues ku vetë ishte me cilësinë e anëtarit me të drejtë vote, duhet të kishte paraqitur dorëheqjen e tij nga procesi, bazuar në nenin 72/73 të Kodit të Procedurës Civile, sikundër edhe vetë është shprehur për një çështje tjetër nga ku hoqi dorë.

59.20.2 Paanësia e tij në këtë vendimmarrje është cenuar.

59.20.3 Ligji *kërkon që në nisje të procesit*, apo edhe në vijim të tij, me rëniën në dijeni të faktit se gjyqtari gjendet në rrethana që e vendosin atë në kushtet e konfliktit të interesit, duhet të zbatojë kërkesat e nenit 72 dhe/ose 73 të Kodit të Procedurës Civile.

59.20.4 Ligji i Aplikueshëm

Kodi i Procedurës Civile / Neni 72/1 /Neni 73

“Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur:

“1. Ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë në gjykim”.

“Gjyqtari, i cili vlerëson me ndërgjegje se ka shkaqe të arsyeshme për të mos marrë pjesë në shqyrtimin e një çështjeje, i kërkon kryetarit të gjykatës zëvendësimin e tij. Kryetari i gjykatës, kur e sheh me vend kërkesën, urdhëron zëvendësimin e tij me një gjyqtar tjetër, me anë të shortit.”

59.20.5 Ligji nr. 9877/2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”⁴³

⁴³ Për shkak të kohës në të cilën ka ndodhur veprimi.

Neni 32

Shkeljet disiplinore

“1. Shkeljet e disiplinës së gjyqtarit ndahen në:

a) shumë të rënda; ...

2. Janë shkelje shumë të rënda aktet dhe sjelljet që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit si më poshtë:

dh) mosbërja e kërkesës për heqje dorë nga gjykimi, kur kjo është e detyrueshme, sipas Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit të Procedurës Civile;”

Vendimi nr. 8, datë 27.02.2014, i Gjykatës Kushtetuese. Pika 17 dhe 18.

Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. **Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njëjës prej palëve.** Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t’u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimet nr. 38, datë 15.10.2007; nr. 25, datë 10.06.2011; nr. 25, datë 11.06.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

Në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit që bindja personale ose interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës dhe, gjithashtu, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim.

→ Në kuptim të testit subjektiv, njëanshmëria e subjektit është e provuar, për shkak të interesit pasuror që subjekti ka pasur me palën ndërgjyqëse të paditur, familjen D.

→ Në kuptim të testit objektiv, ka fakte bindëse që subjekti i rivlerësimit me cilësinë e njërit prej anëtarëve të trupës gjyqësore vë në dyshim paanshmërinë e procesit.

Vendimet ... nr. 11, datë 02.04.2008; nr. 23, datë 04.11.2008; nr. 25, datë 11.06.2013, të Gjykatës Kushtetuese.

59.20.6 Ligji nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Neni 3/përkufizimet, pikat 1, 2, 3 dhe 4/a.

59.20.7 Nga analiza e veprimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni, arriti në konkluzion se subjekti ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e Kodit të Procedurës Civile dhe se veprimet e tij bien ndesh me kërkesat e ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit...”.

59.20.8 Pas kalimit të barrës së provës, subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën. Subjekti pretendon se nuk është përpara nenin 72/1 dhe/ose 73 të Kodit të Procedurës Civile, ndërsa ka vënë në dispozicion vendimin nr. 41, datë 10.10.2013, të Gjykatës Kushtetuese.

59.21 Konkluzione:

- i. Në analizë të parashtrimeve, Komisioni, vlerëson se në çështjen objekt gjykimi subjekti i rivlerësimit ka gjykuar duke qenë në konflikt të hapur interesi, përforcuar kjo me faktin se ai ka qenë ende debitor në shlyerjen e plotë të pasurisë së tij, apartament dhe garazh, ndaj njëres prej palëve të paditura, shtetasve D.
- ii. Gjithashtu, pala paditëse duke qenë e panjohur me marrëdhënien kontraktuale mes palës së paditur dhe subjektit të rivlerësimit, ka qenë në kushtet e pamundësisë për të kërkuar përjashtimin e tij. Nga ana tjetër, pala e paditur e cila ka pasur marrëdhënien kontraktuale me subjektin e rivlerësimit për porosi/shitblerje pasurie, ka qenë jo vetëm e interesuar për praninë e tij në trupën gjyqësore, por edhe ka përfituar nëpërmjet vendimarrjes e cila ka qenë e ndryshme nga ajo e dhënë në shkallë të parë. Në kushte të tilla, i vetmi person i cili do të duhej të tërhiqej nga procesi gjyqësor, për shkaqet e lartpërmendura, me sjelljen e tij të deklaronte konfliktin e interesit, ishte subjekti i rivlerësimit. Subjekti ka kaluar në heshtje këtë situatë duke përfituar nga padijenja e palës paditëse. Komisioni, ka krijuar dyshimin e arsyeshëm se subjekti në formalizimin e kontratës për blerjet e pasurisë, ka përfituar pasurinë garazh në sipërfaqe më të madhe si dhe me çmim preferencial.
- iii. Në këtë këndvështrim interpretimi i dispozitave ligjore reflekton dukshëm situatën e konfliktit të interesit.

C/2 INFORMACIONI I MARRË NË RRUGË ZYRTARE

60. Pranë Komisionit janë depozituar 24 denoncime (sqarojmë këtu se denoncimi i parë i shtetasit A.M., i trajtuar më poshtë, ka parashtruar disa çështje) për subjektin e rivlerësimit, z. Hysni Demiraj, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Pas shqyrtimit të tyre, Komisioni, ka vlerësuar dhe është ndalur për të hetuar për sa vijon:

60.1 Denoncim⁴⁴ i shtetasit A.M.

60.1.1 Denoncuesi, shtetasi A.M., ka denoncuar disa akte dhe gjykime të subjektit të rivlerësimit të kryera apo trajtuara në shkelje me ushtrimin e funksionit të tij.

60.1.2 Denoncuesi ka informuar se ky gjyqtar është relatori i masave të sigurimit, të gjykuara në Gjykatën e Apelit Tiranë, për vrasjet e 21 janarit, ku njëri prej të pandehurve është liruar nga ky gjyqtar dhe Gjykata e Lartë e riktheu përsëri në burg. Korrupsioni ishte aq i hapur, sa ky i pandehur kishte qenë shofer i Prokurorisë Tropojë në kohën kur z. Hysni Demiraj ka qenë Oficer i Policisë Gjyqësore. Gjykimi është qartë i hapur në kundërshtim me ligjin dhe në konflikt të plotë të interesit...

⁴⁴ Nr. ***prot., datë 25.09.2018, në dosjen e Komisionit.

60.1.3 Denoncuesi ka vënë në dispozicion, vendimin nr. ***, datë 14.09.2011, të Gjykatës së Lartë.

60.2 Hetimi i kryer nga Komisioni⁴⁵

60.2.1 Denoncuesi, shtetasi A.M, me *e-mail-in* e dërguar, më datë 12.12.2018, është shprehur se... *“Në lidhje me denoncimin tim po ju shpreh se personi i liruar nga burgu është shtetasi S.Ç., për të cilin, z. Hysni Demiraj, ka ndryshuar masën e sigurimit. Ky vendim është ndryshuar nga Gjykata e Lartë. Gjithashtu, personat që kanë dijeni janë J.M., Prokuror Rrethi, M.M., avokat, si dhe B.M.”.*

60.2.2 Komisioni për një hetim të plotë dhe gjithëpërfshirës, kryesisht lidhur me denoncimin për konflikt interesi në gjykim, midis subjektit të rivlerësimit dhe të pandehurit S.Ç., siç edhe ka deklaruar denoncuesi, është investuar për të kontaktuar dhe ftuar këta persona në cilësinë e dëshmitarit, ndërsa nuk ka arritur të realizojë këtë dëgjesë.

Mbi lidhjen e tij me shtetasin S.Ç., është pyetur subjekti⁴⁶ dhe ka dhënë shpjegimin përkatës.

Analiza e dosjes gjyqësore:

60.2.3 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 11.02.2011, bazuar në nenin 245/ç të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur: Caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” me një afat 30 (tridhjetë) ditë, nga dita e zbatimit të kësaj mase ndaj shtetasit nën hetim S.Ç.

60.2.4. Më tej, Gjykata e Apelit Tiranë, ka shqyrtuar këtë çështje mbi bazë të ankimit të bërë nga i dyshuari i vendosur nën masë arresti “*Burg me afat 30 ditë*”.

60.2.5 Prokurori ka kërkuar miratimin e vendimit nr. ***, datë 11.02.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

60.2.6 Gjykata e Apelit Tiranë, e përbërë nga gjyqtarët Hysni Demiraj me cilësinë e kryesuesit dhe anëtarët Gj.Gj., dhe A.P., ka shqyrtuar çështjen penale me, kërkes: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, kundër: Personit nën hetim S.Ç., i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese në bashkëpunim” dhe “Shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga nenet 79, gërmat “dh”, “e”, 25 dhe 248 të Kodit Penal dhe me vendimin e saj nr. ***, datë 02.03.2011, bazuar në nenin 249/6 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur:

- Shfuqizimin e vendimit penal nr. *** akti, datë 11.02.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Urdhërimin e lirimit të menjëhershëm të arrestuarit S.Ç., në qoftë se nuk mbahet në paraburgim për shkak tjetër ligjor.

⁴⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 06.11.2018, drejtuar Gjykatës së Lartë; Shkresë nr. *** prot., datë 06.11.2018, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; Shkresë nr. *** prot., datë 06.11.2018, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

⁴⁶ Referojuni *e-mail-it* të datës 26 nëntor 2018, provë e administruar në dosjen e Komisionit.

60.2.7 Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë ka paraqitur rekurs Prokurori i Apelit Tiranë.

60.2.8 Gjykata e Lartë, me vendimin e saj, nr. *, datë 14.09.2011, ka vendosur:**

- Prishjen e vendimit nr. ***, datë 02.03.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 11.02.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

60.2.9 Në konkluzion (sipas vendimit të Gjykatës së Lartë), ka rezultuar se:

- Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë është bërë i cenueshëm nëpërmjet ankimit të ushtruar nga prokurori i çështjes.
- Vendimi është marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural penal dhe si i tillë ai është prishur duke u lënë në fuqi vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Gjykata e Lartë e ka cilësuar vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit, rrjedhojë të interpretimit dhe zbatimit të gabuar të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale që parashikojnë masat e sigurimit, kushtet e kriteret për caktimin e tyre (nenet 228-231).
- Gjykata e Lartë ka argumentuar arsyet pse duhej lënë në fuqi vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjykata e Apelit duket se i ka mëshuar themelit të çështjes, ndërsa çështja i takonte thjesht dhe vetëm caktimit të masës së sigurimit personal.
- Në raport me arsyetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykata e Apelit nuk ka arsyetuar ligjërisht të kundërtën.
- Arsyetimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, sikundër ka arsyetuar Gjykata e Lartë në vendimin e saj, nuk ka mbajtur në vëmendje në vendimin e dhënë asnjë prej detyrave të lëna nga Gjykata e Shkallës së Parë, për të cilën ka vendosur edhe masën e arrestit në burg me afat.

61. Çështja civile që i përket vendimit civil, nr. *, datë 09.10.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 08.04.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë.**

61.1 Hetimi i kryer Komisioni⁴⁷

Palët ndërgjyqëse:

Kërkues: L.G.

P/Tretë: V.K., i datëlindjes 08.06.1960, përfaqësuar me prokurë nga av. R.Xh.

A.G., përfaqësuar me prokurë nga av. R.Xh.

A.K.

Objekti: Shkarkim dhe zëvendësim i likuidatores A.K.

Baza Ligjore: Neni 192 dhe 193 i ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

⁴⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 25.10.2018, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë; Shkresë nr. *** prot., datë 24.10.2018, drejtuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë; Shkresë nr. *** prot., datë 24.10.2018, drejtuar Gjykatës së Lartë; Shkresë nr. *** prot., datë 25.10.2018, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin e lartpërmendur ka vendosur:

- Pranimin e kërkesës. Shkarkimin e likuidatores A.K. emëruar me vendimin nr. ***, datë 11.05.2009, dhe zëvendësimin e saj me ekspertin kontabël L.P.

Kundër këtij vendimi rezulton se znj. A.K. ka ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin e saj nr. ***, datë 08.04.2014, ka vendosur:

- Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

61.2 Rrethanat e çështjes:

61.2.1 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin nr. ***, datë 09.10.2012, ka vendosur: “Pranimin e kërkesës. Shkarkimin e likuidatores znj. A.K.,...”

61.2.2 Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim, znj. A.K. dhe z. A.G. Rezulton se kjo çështje është regjistruar në Gjykatën e Apelit Tiranë me nr. ***.

61.2.3 Me procesverbalin e datës **03.07.2013**, gjykata e përbërë nga kryesuese znj. Z.S., anëtarë Hysni Demiraj dhe V.H., ka vendosur të gjykojë në mungesë çështjen civile me kërkues L.G., persona të tretë shtetasit, K., K., etj, duke qenë se nuk ka pasur shkaqe të arsyeshme për mosparaqitje të personave të tretë z. K. dhe A.G. pasi kanë pasur dijeni me shpallje. Në këtë seancë gjykata ka marrë në konsideratë kërkesën e znj. K. për t’u përfaqësuar në gjykim me avokate dhe për shkak se kjo e fundit ka qenë në pamundësi për të marrë pjesë në gjykim në këtë datë, ka shtyrë seancën në datën 19.07.2013.

61.2.4 Me procesverbalin e datës **19.07.2013**, Gjykata e Apelit Tiranë, me të njëjtin trup gjykues (sa sipër), ka shtyrë seancën për datën 27.09.2013, për t’i lënë kohë përfaqësuesit të personave të tretë të z. K., për të çelur dëshminë e trashëgimisë ligjore, **për shkak të parashtrimit të tyre në këtë seancë se, z. K., ka më shumë se tre muaj që ka ndërruar jetë.** Në këtë seancë rezulton se nuk është paraqitur kërkuesi L.G.

61.2.5 Me procesverbalin, datë **27.09.2013**, vërehet se ka marrë pjesë në proces vetëm personi i tretë znj. K., ndërsa për të tjerët gjykata ka pasqyruar se nuk kanë pasur dijeni (as edhe avokati i të ndjerit V.K.) dhe për këtë shkak seanca është shtyrë më datë 14.10.2013.

61.2.6 Në procesverbalin, datës **14.10.2013**, me të njëjtin trup gjykues është pasqyruar prezenca e palëve në proces, nga ku ka rezultuar edhe pjesëmarrja e avokatit të familjes K. dhe njëkohësisht është pyetur ky i fundit lidhur me çeljen e dëshmisë së trashëgimisë për të ndjerin V.K.

61.2.7 Në këtë seancë avokati ka sqaruar se trashëgimtarët nuk kanë dashur të çelin trashëgiminë pasi kanë si zakon nga ana e tyre se nuk kryejnë asnjë zakon pa kaluar 1 vit nga vdekja. **Avokati ka parashtruar në këtë seancë se depoziton certifikatën e vdekjes, familjaren dhe certifikatat e familjarëve të të ndjerit V.K. dhe ka kërkuar që të bëhet zëvendësimi procedural nëpërmjet këtyre**

akteve. Në certifikatën familjare, datë 14.10.2013, lëshuar nga Njësia Bashkiake /Komuna Krujë ***, Zyra e Gjendjes Civile Krujë, rezulton se shtetasi V.K., ka vdekur më datë 04.01.2013. Në dosje janë administruar edhe certifikatat e shtetasve E.K., B.K., Sh.K. dhe V.K., lëshuar, më datë 14.10.2013, nga zyra e gjendjes civile përmendur më sipër.

61.2.8 Gjykata mbi këtë kërkesë, bazuar në nenin 199 të Kodit të Procedurës Civile ka bërë kalimin procedural dhe thirrjen si persona të tretë, Sh.K. dhe dy fëmijët, B. dhe E.K. Seanca është shtyrë për datën 28.10.2013, për të bërë njoftimin e këtyre palëve dhe shpalljen e personit të tretë A.G.,..

61.2.9 Sipas procesverbalit, datë **28.10.2013**, është shtyrë seanca për datën 11.11.2013 për shkak të mungesës së trashëgimtarëve të të ndjerit K. Gjithashtu në këtë procesverbal është pasqyruar se avokati i të ndjerit V.K., përfaqëson edhe personin e tretë z. A.G. dhe paraqet përpara gjykatës një prokurë të përgjithshme...

61.2.10 Kanë vijuar seancat sipas procesverbalit të datës **11.11.2013** dhe 25.11.2013 (në të cilën pasqyrohet dorëzimi i prokurës së përgjithshme nr. ***, datë 22.01.2007, 09.12.2013, 24.12.2013 (pasqyrohet përbërja e trupit gjykues dhe paraqitet kërkesë nga znj. K. për përjashtimin e relatores së çështjes znj. S. dhe znj. H., pasi kanë marrë pjesë në gjykime penale ndaj vetë znj. K.)... Në këtë procesverbal është pasqyruar ndërprerja e seancës dhe shqyrtimi i kërkesës nga një tjetër trup gjykues dhe se palët do të njoftohen me fletëthirrje për seancën e radhës.

61.2.11 Në shpalljen e datës 11.11.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë për zhvillim të seancës gjyqësore, më datë 25.11.2013, rezulton se në cilësinë e personave të tretë janë: Sh.K., B., E.K.... *Në procesverbalet e datës 05.02.2014 dhe 17.02.2014 pasqyrohet tjetër përbërje e trupit gjykues.*

61.2.12 Në procesverbalin e datës 08.04.2014, pasqyrohet fakti i vazhdimit të procesit gjyqësor, dëgjimi i parashtrimeve të kërkuarit L.G., tërheqja e trupit gjykues për të marrë vendim, si dhe shpallja e vendimit: “Lënie në fuqi e vendimit nr. ***, datë 09.10.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë”.

61.2.13 Aktualisht çështja është në Gjykatën e Lartë e rekursuar nga znj. K.

61.2.14 Mbi këtë çështje Ministria e Drejtësisë është vënë në lëvizje nga ankesa e znj. K. e cila është ankuar, më datë 27.01.2016, përkatësisht ndaj vendimit nr. ***, datë 08.04.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

61.2.14.1 Ky institucion me shkresën nr. *** prot., datë 01.02.2016, ka dërguar ankesën pranë KLD-së me argumentin se, referuar nenit 2 dhe 8 të Memorandumit të Bashkëpunimit të nënshkruar midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë” “Për shmangien e mbivendosjes së kompetencave në inspektimin Gjyqësor” ka rezultuar se kjo ankesë po trajtohej prej tyre/KLD-së. Më tej Ministria e Drejtësisë ka kërkuar edhe vënien në dosje në përfundim të shqyrtimit të kësaj problematike.

61.2.14.2 KLD-ja në informacionin e dhënë ka bërë me dije se ky institucion ka shqyrtuar ankesën e znj. K. me relacion paraprak, më datë 09.09.2016, dhe ka konkluduar se kjo ankesë duhet të mbahet në vijim deri në përfundim të gjykimit në Gjykatën e Lartë. KLD-ja në informacionin e

dhënë ka sqaruar se çështja në Gjykatën e Lartë është me statusin “studim i çështjes”. KLD ka vënë në dispozicion edhe korrespondencën e mbajtur me ankuesen për komunikimin e konkluzioneve të arritura, shkresën nr. *** prot., datë 11.11.2016, si dhe memon e datës 09.09.2016 të Inspektorese së KLD-së drejtuar Kryeinspektorese. Në memo ndër të tjera rezulton se subjekti i rivlerësimit pasi është njohur me ankesën është pyetur lidhur me shqyrtimin dhe vendimmarrjen e kësaj çështjeje. Vërehet se subjekti i rivlerësimit kryesisht në deklarin e dhënë është marrë me pozitën e ankueses në këtë proces gjyqësor, legjitimitetin e saj në këtë pretendim, me prezencën e saj apo me mënyrën se si ankuesja ka marrë njoftimin e vendimit.

61.3 Ligji i Aplikueshëm

Kodi i Procedurës Civile / Neni 199 / Kalimi procedural

Kur njëra nga palët vdes, çështja vazhdon nga ose kundër trashëgimtarëve të saj...

Neni 297⁴⁸/ Pezullimi i gjykimit / Kodi civil / Neni 348⁴⁹

61.4 Për sa më sipër, Komisioni, ka konstatuar se:

- i. Në çështjen objekti gjykimi, gjykata me të rënë në dijeni të faktit se njëri prej palëve ndërgjyqëse ka ndërruar jetë, do të duhej të kishte zbatuar nenin 297 të Kodit Civil, pra duhej të kishte pezulluar çështjen deri në çeljen e dëshmisë së trashëgimisë.
- ii. Legjitimiteti i trashëgimtarëve në proces gjyqësor provohet me aktin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore apo testamentare, ky ka qenë dhe është qëllimi i ligjvënësit në parashikimin e nenit 348 të Kodit Civil.
- iii. Dëshmia e trashëgimisë përcakton rrethin e trashëgimtarëve të trashëgimlënësit. Pavarësisht se është standard deklarativ dhe mund të kundërshtohet në çdo kohë, pasojat e saj kur pretendohen pavlefshmëri, iniciojnë palët për të ushtruar kërtime të mëtejshme me padi.
- iv. Neni 199 i Kodit të Procedurës Civile thjesht dhe vetëm parashikon kalimin procedural të trashëgimtarëve në proces gjyqësor.
- v. Akti që bën të mundur këtë kalim është dëshmia e trashëgimisë dhe jo certifikatat e trungut familjar apo gjendjes personale. Këto dokumente janë në shërbim të çeljes së dëshmisë së trashëgimisë dhe jo në shërbim të drejtpërdrejtë të procesit civil siç është vepruar nga gjykata.
- vi. Megjithëse çështja është ende në gjykim duket se, subjekti i rivlerësimit, z. Hysni Demiraj, ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 199, 297 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 348 të Kodit Civil.
 - ➔ Bazuar në ligjin e aplikueshëm në këtë çështje, mbi këto konstatime, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime mbi veprimet procedurale të kryera, për sa i përket zëvendësimit të trashëgimlënësit me trashëgimtarët ligjorë; si dhe
 - ➔ Të japë shpjegime lidhur me përbërjen e një tjetër trupi gjykues pasqyruar në procesverbalin, datë 05.02.2014 dhe 17.02.2014, si dhe të qartësojë me dokumente

⁴⁸ ...

c) njëra nga palët vdes ose mbaron personi juridik;
...Gjatë pezullimit nuk mund të kryhen veprime procedurale.

Cilësia si trashëgimtar dhe pjesët takuese në trashëgim caktohen në dëshminë e trashëgimisë, ... gjithashtu, nenet 316, 318, paragrafi i parë, 319 të po këtij kodi, por edhe sipas rregullave të caktuara në Kodin e Procedurës Civile.

provuese ndryshimin e përbërjes së trupit gjykues në procesverbalin e datës 08.04.2014, ku subjekti ka qenë në cilësinë e kryesuesit të kësaj çështjeje.

61.5 Konkluzione:

- i. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit, ka vijuar të trajtojë rastin sikur Komisioni është fokusuar në arsyet e zhvillimit të procesit gjyqësor më palë ndërgjyqëse të cilët kanë ndërruar jetë.
- ii. Ndryshe nga se e zhvendos argumentin e tij subjekti i rivlerësimit, Komisioni, ka argumentuar në këtë çështje faktin se trupi gjykues ku bën pjesë edhe subjekti i rivlerësimit ka bërë zëvendësimin e palës ndërgjyqëse që ka ndërruar jetë duke anashkuar dëshminë e trashëgimisë dhe bërë zëvendësimin e trashëgimlënësit bazuar në nenin 199 të Kodit të Procedurës Civile. Nëse i referohemi shpjegimeve⁵⁰ që subjekti i rivlerësimit ka dhënë kur është pyetur nga inspektorë të KLD-së (në memon datë 09.09.2016), vërejmë se ndër të tjera ai është shprehur se trupi gjykues ka bërë verifikimin e nevojshëm në fashikullin gjyqësor të Gjykatës së Shkallës së Parë, dhe rezulton të mos kishte asnjë certifikatë vdekje, pasi kjo certifikatë ishte administruar nga trupi gjykues që ka hequr dorë nga gjykimi. Në fakt nuk ka ndodhur kështu. Në procesverbalin, datë 14.10.2013, pasqyrohet i njëjti trup gjykues ku bën pjesë subjekti i rivlerësimit dhe po në këtë akt është depozituar nga avokati, certifikata e vdekjes së të ndjerit V.K. si dhe certifikatat e tjera familjare apo personale.
- iii. Subjekti depozitoi një deklaratë noteriale, datë 04.02.2019, të shtetasit E.K. në të cilën deklarohet se ndaj vendimit të lartpërmendur nuk është ushtruar ankim, se palët kanë zgjidhur konfliktin me pajtim dhe se nuk kanë qenë të interesuar për pjesëmarrje në gjykim.
- iv. Komisioni, çmon se deklarata e marrë pikërisht palës në gjykim (pavarësisht përfundimit të procesit gjyqësor), për të cilën edhe trajtohet shkelja e kryer, nisur nga funksioni që subjekti ushtron, krijon bindjen e një marrëdhënie me palën gjatë dhe pas gjykimit, fakt i cili rëndon pozitën e një funksioni të tillë.
- v. Konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me parashikimet e bëra në Kodin e Procedurës Civile dhe Kodin Civil.
- vi. Për sa i përket konstatimit tjetër të Komisionit, subjekti ka vënë në dispozicion vendimin administrativ nr. ***prot., datë 11.03.2016, dhënë prej tij, i cili është në vijueshmëri të vendimit të mëparshëm nr. *** prot., datë 17.11. 2011, lidhur me mënyrën se si veprohet në rastet e zëvendësimeve të gjyqtarëve me cilësi relatori apo anëtar si dhe rihedhjet në short.
- vii. Pas verifikimit, rezulton se subjekti bazuar në vendimin nr. *** prot., datë 11.03.2016, ka marrë atributin e relatorit.
- viii. Subjekti nuk depozitoi vendimin nr. *** prot., datë 17.11.2011.
- ix. Vendimi administrativ nr. ***, datë 11.03.2016, i subjekti të rivlerësimit nuk është në përputhje me dispozitat ligjore në të cilat është mbështetur dhënia e tij. Shkronja “g” e nenit 18 të ligjit nr. 9877/2008, i jep kompetenca pozicionit të kryetarit të gjykatës që të kryejë detyra të tjera në funksion të drejtimit administrativ të gjykatës.... Drejtimi administrativ nuk nënkupton rregullimin e trupave gjyqësore në rastet e përjashtimeve të gjyqtarëve. Këtë rregullim e kanë bërë ligjet procedurale të marra me shumicë të cilësuar, të cilat konkurrojnë mbi vendimmarrje të kësaj natyre.

⁵⁰ Shih dokumentin nr. *** prot., datë 29.10.2018, në dosjen e Komisionit

- x. Komisioni krijon dyshime të arsyeshme se nëpërmjet këtij vendimi, marrja e cilësisë së relatorit kryesisht kur përjashtohet relatori i zgjedhur me short si dhe një anëtar, humb sigurinë e transparencës së gjykimit të një çështje.

62. Çështja F.Sh.

62.1 Në këtë çështje sipas denoncuesit, gjyqtari Hysni Demiraj, merr në shqyrtim kërkesën për përjashtim të një tjetër trupi gjykues, por në baza korruptive, bashkë me gjyqtarët e trupit gjykues vazhdojnë gjykimin e themelit të çështjes. Kjo në kundërshtim të hapur me ligjin dhe me procedurën që ndiqej.

62.2 Hetimi i kryer nga Komisioni ⁵¹

Analiza e provave:

62.2.1 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me vendimin nr. ***, datë 30.12.2014, për çështjen penale me të pandehur: F.Sh., akuzuar për veprën penale të mashtrimit, bazuar në nenin 143/2 të Kodit Penal, ka vendosur: Deklarimin fajtor të të pandehurit F.Sh. për kryerjen e veprës penale të “Mashtrimit” dhe në bazë të nenit 143/2 të Kodit Penal, dënimin e tij me 15 vite burgim.

62.2.2 Mbi ankimin e të pandehurit dhe apelit kundërshtues të organit të Prokurorisë së Apelit Tiranë, është vënë në lëvizje Gjykata e Apelit Tiranë, e cila me vendimin e saj penal nr. ***, datë 19.11.2015, ka vendosur: *Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 30.12.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.*

62.2.3 Me procesverbalin, datë 23.09.2015, rezulton se çështja fillimisht po shqyrtohej nga trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët A.H., F.Q., dhe V.H.

62.2.4 Në procesverbalin, datë 30.09.2015, pasqyrohet se përfaqësuesja ligjore e të pandehurit, znj. S.P., ka kërkuar përjashtimin e trupit gjykues pasi ky trup gjykues është shprehur më parë me vendimin nr. ***, datë 09.09.2015. Kërkesa e avokates konfirmohet se vjen si pasojë e vendimit gjyqësor nr. ***, datë 09.09.2015, akt i cili është administruar në dosjen penale. Në këto kushte, në procesverbal është pasqyruar se gjykata e këshilluar në vend ka deklaruar se nuk mund të bëjë asnjë veprim tjetër procedural dhe se ndërpret shqyrtimin gjyqësor në pritje që një trup tjetër gjykues të shprehet për kërkesën e paraqitur gojarisht nga ku ka sqaruar se do ta depozitonte atë me shkrim.

62.2.5 Në dosje është administruar procesverbali, datë 22.10.2015, ku pasqyrohet përbërja tjetër e trupit gjykues në të cilën bën pjesë si anëtar i çështjes edhe subjekti i rivlerësimit, mungesa e të pandehurit dhe avokates së tij, por për shkak të mosformimit të trupit gjykues për mungesë të një gjyqtari i cili është pasqyruar se ndodhej në seminar, është shtyrë seanca më datë 29.10.2015.

62.2.6 Nga aktet e administruara në dosje rezulton se kjo çështje është shqyrtuar dhe përfunduar nga trupi gjykues i përbërë nga kryesues Gj. Gj dhe anëtarë, subjekti i rivlerësimit, z. Hysni Demiraj dhe gjyqtari M.S.

- *Në dosje nuk rezulton i administruar asnjë akt procedural mbi ndryshimin e trupit gjykues.*

⁵¹ Shkresë nr. *** prot., datë 25.10.2018, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat; Shkresë nr. *** prot., datë 25.10.2018, drejtuar Gjykatës së Lartë

62.2.7 Në procesverbalin, datë 29.10.2015, është pasqyruar trupi gjykues dhe shtyrja e seancës për datë 12.11.2015, për shkak të mosmarrjes dijeni të të pandehurit dhe avokates megjithëse janë njoftuar me telegram. Më tej kanë vijuar seancat me të njëjtin trup gjykues ku në cilësinë e anëtarit ka vijuar të jetë edhe subjekti i rivlerësimit. Më datë 19.11.2015 (sipas procesverbalit gjyqësor), ka përfunduar gjykimi i çështjes duke u shprehur gjykata për lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Mat. Në këtë seancë rezultoi se ka qenë prezent edhe avokatja e të pandehurit.

62.3 Ligji i Aplikueshëm

**Kodi i Procedurës Penale / Neni 19/ Afatet dhe format e kërimit të përjashtimit⁵²
Neni 21⁵³/ Kompetencat për të vendosur përjashtimin / Neni 23⁵⁴**

- Për sa më sipër, subjektit i është kërkuar që në nivelin e provueshmërisë që kanë qenë provat, të japë shpjegime dhe të provojë me dokumente veprimet procedurale të kërkuara ligjërisht dhe të kryera në rastet e kërkesës për përjashtim gjyqtari nga trupi gjykues, ose për përjashtimin e trupit gjykues në tërësi, deri në fazën e kalimit të kësaj çështje për tu gjykuar nga përbërja e re e trupit gjykues ku bëni pjesë edhe ju.

62.4 Pas kalimit të barrës së provës, subjekti në prapsimet e tij, ndër të tjera ka sqaruar se *qe ne fillim, duhet theksuar se drejtuesi i gjykates dhe kancelari (ne kohen e gjykimit te çeshtjes, drejtues gjykate ka qene denancuesi) kane kaluar kerkesen per perjashtim trupe gjyqesore, pa u dorezuar kerkesa me shkrim ne gjykate. Pra ne fashikullin gjyqesor nuk ka kerkesa me shkrim per perjashtim gjyqtari....*

62.5 Konkluzione:

⁵² 1. Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit bëhet në seancë menjëherë pas legjitimitit të palëve.

2. ... Kur shkak ka lindur ose është zbuluar gjatë seancës kërkesa e përjashtimit duhet të bëhet para mbarimit të seancës.

3. Kërkesa përmban shkaqet e provat dhe parashtrohet me akt të shkruar. Ajo paraqitet, bashkë me dokumentet, në sekretarinë e gjykatës kompetente. Një kopje e kërkesës i jepet gjyqtarit për të cilin kërkohet përjashtimi.

4. Kur nuk bëhet personalisht nga palët, kërkesa mund të paraqitet me anën e mbrojtësit ose të një përfaqësuesi të posaçëm. Në prokurë duhet të tregohen shkaqet për të cilat kërkohet përjashtimi, ndryshe ajo nuk pranohet.

⁵³ (Ndryshuar paragrafi I me ligjin nr. 8813, datë 13.6.2002).

1. Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarëve shqyrtohet në seancë nga një gjyqtar tjetër i së njëjtës gjykatë. Ndaj vendimit për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për përjashtim lejohet ankimi së bashku me vendimin përfundimtar të çështjes.

...

3. Nuk pranohet kërkesa për përjashtimin e gjyqtarëve të caktuar për të vendosur mbi përjashtimin.

⁵⁴ 1. Kur deklarimi i heqjes dorë ose kërkesa e përjashtimit pranohen, gjyqtari nuk mund të kryejë asnjë veprim procedim.

2. Akti që pranon deklarimin e heqjes dorë ose kërkesën e përjashtimit cakton nëse dhe në c' pjesë kanë vlerë veprimet e kryera më parë nga gjyqtari që ka hequr dorë ose që është kërkuar të përjashtohet.

3. Dispozitat për heqjen dorë dhe përjashtimin e gjyqtarit zbatohen edhe për sekretarin e seancës dhe personat e ngarkuar për të bërë transkriptime ose riprodhim fonografik apo audioviziv. Për heqjen dorë ose përjashtimin e tyre vendos gjykata që shqyrton çështjen.

- i. Komisioni në këtë rast mban në vëmendje faktin që subjekti i rivlerësimit ka nisur detyrën e Kryetarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, më datë 07.03.2016, faktin që subjekti i rivlerësimit është në cilësinë e anëtarit dhe jo të relatorit të çështjes, faktin që subjekti deklaroi se në fashikull nuk ka kërkesë me shkrim të palës për përjashtim trupi gjyqësor; por pavarësisht kësaj.
- ii. Komisioni, konstaton se subjekti nuk paraqiti aktet (procesverbalin, etj) e tjera që provojnë rihedhjen e kësaj çështje në short.

63. Denoncime të tjera të depozituara nga disa shtetas, bazuar në nenin 53, të ligjin nr. 84/2016.

63.1 Denoncim⁵⁵ i shtetasit M.B.

Denoncuesi ankohet për vendim të padrejtë të marrë nga subjekti i rivlerësimit dhe proces jo të rregullt ligjor.

Nga përmbajtja e ankimit rezultoi se Gjykata e Apelit Tiranë, në përbërje të së cilës ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 03.10.2017, ka vendosur: Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 25.08.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, duke caktuar si masë sigurimi personal ndaj këtij shtetasi "Arrestin me burg" të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

Ankuesi pretendon se në marrjen e këtij vendimi Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka verifikuar faktin nëse kishte kompetencë tokësore, pasi vepra penale për të cilën ai akuzohej kishte ndodhur në juridiksionin tokësor të rrethit *Durrës*...

Gjithashtu, ankuesi pretendon se gjykimi është bërë pa pjesëmarrjen e tij dhe as duke njoftuar avokatin e përzgjedhur, *ndonëse njihet adresa (vijon të sqarohet ankuesi) ime dhe e avokatit*, për pasojë prej ankuesit pretendohet se është zhvilluar një gjykim formal duke u mohuar në mënyrë arbitrare e drejta për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor...

- ➔ Subjektit i është kërkuar të japë shpjegime mbi këtë denoncim, si dhe provojë me dokumente justifikuese veprimet e kryera në këtë proces gjyqësor.

Subjekti në parashtrimet e tij ka qartësuar se çështja e kompetencës tokësore nuk është ngritur në rekursin e drejtuar Gjykatës së Lartë dhe njëkohësisht ka depozituar vendimin e Gjykatës së Lartë nr. ***, datë 16.02.2018, i cili ka lënë në fuqi vendimin e dhënë nga Gjykata e Apelit Tiranë, nr. ***, datë 03.10.2017, gjykim i zhvilluar nga trupi gjyqësor ku subjekti i rivlerësimit ka qenë në cilësinë e relatorit.

63.2 Denoncim⁵⁶ i shtetasit B.Sh.

Denoncuesi ankohet lidhur me vendimin nr. ***, datë 27.02.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë, si vendim i padrejtë i dhënë duke favorizuar firmën e ndërtimit " *** " me pretendimin se subjekti ka njohje me pronarin e firmës. Ai gjithashtu shprehet në denoncim se gjyqtari Hysni Demiraj ka favorizuar palën kundërshtare sepse fillimisht ka qenë tjetër relator dhe më pas është ndërruar. Nuk

⁵⁵ Nr. *** prot., datë 02.02.2017.

⁵⁶ Nr. *** prot., datë 21.03.2018, dhe nr. *** prot., datë 23.03.2018.

ka sqaruar nëse ka depozituar rekurs ndaj këtij vendimi. Dokumentacioni i depozituar në denoncim nuk është i plotë.

- ➔ Subjektit i është kërkuar të japë shpjegime dhe të depozitojë dokumentacion justifikues procedural që tregon veprimet e ndërmarra lidhur me ndryshimin e gjyqtarit në këtë çështje apo të trupës gjyqese në tërësi.

Subjekti ka paraqitur shpjegimet e tij dhe njëkohësisht ka vënë në dispozicion të Komisionit:

- Tri fletë nga regjistrimi i veprimeve të çështjes.
- Vendimin e marrë prej subjektit të rivlerësimit nr. *** prot, datë 11.03.2016.
- Vendim nr. *** prot., datë 13.12.2017.
- Vendim nr. *** prot., datë 29.01.2018.
- Kërkesë për dorëheqje të dy anëtarëve të trupit gjyqes, datë 30.01.2018.
- Vendim nr. *** , datë 2.02.2018.
- Vendim nr. *** prot., datë 7.02.2018.
- Procesverbal i seancës gjyqësore, datë 12.12.2017.
- Procesverbal i seancës gjyqësore, datë 30.01.2018.
- Procesverbal i seancës gjyqësore, datë 23.02.2018.
- Procesverbal i seancës gjyqësore, datë 27.02.2018.
- Procesverbal i seancës gjyqësore, datë 08.02.2018.

Nga aktet rezulton se çështja ka nisur me trupin gjyqes të përbërë nga gjyqtarët E.T., E.Dh. dhe subjekti i rivlerësimit. Në seancën e datës 13.12.2017, dy anëtarët e trupit janë shprehur se kanë gjykuar më parë çështje me këto palë dhe se do të paraqesin dorëheqjen.

Me vendimin nr. *** , datë 13.12.2017, subjekti i rivlerësimit me cilësinë e Kryetarit të Gjykatës së Apelit ka vendosur, pranimin e kërkesës së dorëheqjes.

Konkluzione:

- i. Nga aktet e depozituara nga subjekti, nuk është vënë në dispozicion kërkesë me shkrim për dorëheqje nga gjykimi i kësaj çështje nga gjyqtarët E.T. dhe E.LI.
- ii. Subjekti ka miratuar dorëheqjen e gjyqtarëve, më datë 13.12.2017, pa pasur më parë kërkesën me shkrim të tyre.
- iii. Subjekti ndryshe nga se pranon dorëheqjet e para pa kërkesë me shkrim, ka miratuar kërkesën e dy anëtarëve zëvendësues V.H. dhe A.H. (pasi edhe për ta është kërkuar dorëheqja nga gjykimi i kësaj çështje), më datë 02.02.2018, vetëm pasi është depozituar prej tyre kërkesa me shkrim, më datë 30.01.2018.
- iv. Subjekti në rastin më sipër që i përket denoncimit për çështjen penale në ngarkim të pandehurit F.Sh. është shprehur se: *“Unë gjatë punës tre vjeçare si drejtues nuk kam kaluar asnjë çështje ... pa kërkesën me shkrim tek asnjë gjyqtar i kësaj gjykate.”*, ndërsa konstatohet se ka vepruar krejt ndryshe dhe për pasojë në kundërshtim me paragrafin e fundit të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile.

63.3 Kallëzimi penal i shtetases A.H. (B.).

Hetimi i kryer nga Komisioni:

- Shkresë nr. *** prot., datë 25.10.2018, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.
- Me shkresën nr. *** prot., datë 29.10.2018, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, ka vënë në dispozicion fashikullin e plotë të kallëzimit penal nr. *** , datë 04.05.2015.

Me kallëzimin penal të datës 11.04.2015, kallëzuesja A.H. (B.), bazuar në nenin 283 dhe 284 të Kodit Penal ka kallëzuar ndër të tjerë subjektin e rivlerësimit, z. Hysni Demiraj, për veprën penale “Shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Rrethanat e çështjes:

Në përgjithësi në kallëzim trajtohen procese civile të zhvilluara në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë për çështje pronësore, pavlefshmëri të veprimeve juridike, etj mes bashkëpronarëve lidhur me vendime të KKK Pronave, etj. ...

Kallëzuesja ka parashtruar se gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, ndër të cilët bën pjesë edhe subjekti i rivlerësimit, në çështjen civile që kanë gjykuar i kanë sjellë palës gjyq fituese përfitime kolosale të padrejta duke zbatuar me dashje gabim ligjin.

Me shkresën nr. *** prot., datë 28.04.2015, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka dërguar për kompetencë kallëzimin penal pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Me shkresën nr. *** prot, datë 06.05.2015, Prokuroria e Përgjithshme (drejtoria Task – Forcë) i është drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan për verifikimin dhe vlerësimin ligjor të pretendimeve të ngritura në kallëzimin e shtetases A.H. (B.).

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, më datë 11 maj 2015, bazuar në nenin 290, pika 1, germa “ç” dhe nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur: “Mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. ***, viti 2015”.

63.4 Denoncimi⁵⁷ i shtetases Xh.J.

Denoncuesja denoncon subjektin e rivlerësimit për korrupsion dhe zvarritje të proceseve gjyqësore. Znj. Xh.J., ankohet ndaj ndryshimit të vendimit nr. *** , datë 11.11.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin nr. *** , datë 18.04.2017, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Vendimi gjyqësor civil i përket palëve ndërgjyqëse, paditëse Xh.J., të paditur, shtetasi R.K., etj, me objekt/ Shpërbllim dëmi. Me vendimin nr. *** , datë 11.11.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, ka vendosur: “Pranimin e pjesëshëm të padisë duke detyruar të paditurit të dëmshpërblejnë paditësen, znj. Xh.J., në shumën 138.950 lekë, ... shpenzimet gjyqësore në masën 20 % u ngarkohen palëve të paditura”.

Vërehet nga arsyetimi se kërkimi i dëmit të shkaktuar ka qenë mbi disa kërkesa prej të cilave është pranuar vetëm njëra prej tyre e për pasojë bazuar në nenin 106 të Kodit të Procedurës Civile edhe ndarja e shpenzimeve gjyqësore vlerësohet në raport me pjesën e padisë që është pranuar. Gjykata e Apelit Tiranë ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin, ndërsa ka

⁵⁷ Nr. *** prot., datë 05.12.2017.

ndryshuar pjesën që i përket shpenzimeve gjyqësore duke vendosur ndarjen e tyre në barazi mes palëve në 50 %.

Denoncuesja ankohet ndaj kësaj ndarje të shpenzimeve gjyqësore, ndërsa pretendon se kjo vendimmarrje nuk është e drejtë për shkak se ajo është palë e dëmtuar. Arsyetimi i Gjykatës së Apelit Tiranë mban të njëjtën linjë me atë të shkallës së parë, ndërsa vlerëson në favor të paditëses, në këtë rast denoncueses, një vlerë më të ulët të pagimit nga ana e saj të shpenzimeve gjyqësore në raport me atë të vendosur në Gjykatën e Shkallës së Parë Kurbin. Gjykata e Apelit Tiranë ashtu sikundër edhe ajo e shkallës së parë, nuk ka quajtur të provuar disa prej kërkesave për dëmin e shkaktuar, ... të cilat kanë sjellë pranimin e pjesëshëm të padisë. Në vendim vërehet se nuk janë pasqyruar vlerat e kërkuara nga paditësja mbi dëmet e shkaktuara. Gjithsesi vendimmarrja e Gjykatës së Apelit Tiranë për përcaktimin e raportit të shpenzimeve gjyqësore, vlerësohet se nuk përbën indice për trajtimin e mëtejshëm nga Komisioni.

63.5 Denoncim⁵⁸ i shtetasit Ç.I.

Denoncuesi ankohet ndaj vendimit nr. ***, datë 06.05.1998, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, ku subjekti i rivlerësimit ka pasur cilësinë e kryetarit të seancës gjyqësore. Nga këqyrja e vendimit rezulton se ai ka marrë formë të prerë.

63.6 Denoncim⁵⁹ e shtetasit I.D.

Denoncuesja ankohet për vendim të padrejtë për çështje pronësore, të dhënë nga Gjykata e Apelit Tiranë ku ka qenë pjesë e trupit gjykues edhe subjekti i rivlerësimit, duke saktësuar për përfshirje në procesin gjyqësor të palëve të cilët nuk kanë lidhje me të. Denoncuesja ka vënë në dispozicion vendimin nr. ***, datë 14.11.2017, të Gjykatës së Apelit Tiranë, sipas të cilit është vendosur: “Ndryshimi i vendimit nr. ***, datë 27.12.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”. Nuk sqarohet nëse kundër këtij vendimi është bërë rekurs, por megjithëkëtë vlerësohet se ankimi i përket themelit të çështjes çka nuk përbën objekt shqyrtimi nga Komisioni.

63.7 Denoncim⁶⁰ i shtetasit Z.K.

Denoncuesi ankohet ndaj vendimit civil të Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. ***, datë 29.03.2016, sipas të cilit me këtë vendimmarrje padrejtësisht janë bërë pjesëtare në pronësinë ku kam qenë ortak i vetëm edhe të tjerë. Nga trajtimi i denoncimit vlerësohet se pretendimi i takon themelit të çështjet.

63.8 Denoncim⁶¹ i shtetasit M.B.

Denoncuesi ankohet ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. ***, datë 12.09.2012, i cili ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me pretendimin “*dyshtoj se kanë marrë rryshfet*”, për shkak të lidhjeve me avokatin e palës së paditur. Vendimi është ankimuar dhe për pasojë çështja i nënshtrohet gjykimit në gjykatat e shkallëve më lartë.

⁵⁸ Nr. *** prot., datë 12.12.2017.

⁵⁹ Nr. *** prot., datë 21.03.2018.

⁶⁰ Nr. *** prot., datë 22.02.2018.

⁶¹ Nr. *** prot., datë 23.11.2017.

63.9 Denoncim⁶² i shtetasit S.R.

Denoncuesi (i cili ka ndërruar jetë) i pasuar nga trashëgimtarët e tij (shtetasi H.R.) pretendon për zhvillim të një procesi gjyqësor jo të rregullt ligjor, zvarritje në proces, zbardhje dhe vënie në dispozicion të vendimit për përjashtim gjyqtari, korrupsion, kontroll figure si dhe aftësi profesionale. Lidhur me pretendimin për vënien në dispozicion të vendimit për përjashtimin e gjyqtarit, Gjykata e Apelit Tiranë, ka njoftuar ankuesin me shkresën nr. *** prot., datë 28.06.2018, se ai gjendet në dosjen objekt gjykimi e cila ndodhet në Gjykatën e Lartë. Pas njohjes me denoncimin, konstatohet se në kërkimin përfundimtar të tij, drejtuar disa organeve të sistemit të drejtësisë lidhur me shkelje të pretenduara, të kryera nga gjyqtarë konkret apo punonjës të administratës, denoncuesi nuk specifikon asnjë ankesë lidhur me subjektin e rivlerësimit.

63.10 Denoncim⁶³ i shtetasit Sh.M.

Denoncuesi ankohet ndaj vendimit nr. ***, datë 12.03.2015, i cili ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe që ka të bëjë me çështje pronësie. Ankimi i referohet themelit të çështjes, proces i cili zgjidhet në të tri shkallët e gjyqësorit duke ushtruar të drejtën e ankimit.

63.11 Denoncim i shtetasit M.H.

Denoncuesi në ankesën e tij ankohet për disa gjyqtarë në mënyrë të drejtpërdrejte, ku ka përmendur edhe subjektin e rivlerësimit por nuk jep arsye në ankim mbi të. Edhe dokumentacioni i administruar i përket vendimit të dhënë nga një tjetër gjyqtar dhe jo nga subjekti i rivlerësimit.

63.12 Denoncim⁶⁴ i shtetasit N.M.

Denoncuesi në ankimin e tij nuk ngre pretendime mbi subjektin e rivlerësimit. Nga dokumentacioni i depozituar prej tij, vërehen disa vendime gjyqësore, për të cilët ankuesi sqaron dhe ankohet edhe mbi ekzekutimin e tyre apo edhe mbi një kallëzim penal të mosfilluar por që nuk kanë lidhje me subjektin e rivlerësimit.

63.13 Denoncim i shtetasit⁶⁵ L.D.

Denoncuesja ankohet ndaj një vendimi gjyqësor me objekt kundërshtim i veprimeve përmbartimore për të cilin edhe ka ushtruar të drejtën e ankimit. Ankimi i parashtruar i përket themelit të çështjes.

63.14 Denoncim⁶⁶ i shtetasit F.K.

Denoncuesi ankohet ndaj themelit të një çështje pronësore e cila nuk është në kompetencë të trajtimit nga ana e Komisionit.

63.15 Denoncim⁶⁷ i shtetasit A.H.

⁶² Nr. *** prot., datë 07.02.2018, nr. *** prot., datë 29.05.2018 dhe nr. *** prot., datë 27.06.2018, nr. *** prot., datë 13.08.2018.

⁶³ Nr. *** prot., datë 30.03.2018.

⁶⁴ Nr. *** prot., datë 23.05.2018 dhe nr. *** prot., datë 23.05.2018.

⁶⁵ Nr. *** prot., datë 12.06.2018.

⁶⁶ Nr. *** , datë 18.07.2018.

⁶⁷ Nr. *** prot., datë 27.06.2018.

Denoncuesi ankohet ndaj vendimit gjyqësor të Gjykatës së Apelit Tiranë i dhënë nga një trupë gjykuese pjesë e së cilës nuk rezulton të jetë subjekti i rivlerësimit. Ndërkohë ankuesi ka depozituar rekurs ndaj vendimit dhe çështja vijon të jetë në Gjykatën e Lartë për shqyrtim.

63.16 Denoncim⁶⁸ i shtetasit M.H., me cilësinë e avokatit.

Denoncuesi ankohet ndaj vendimit penal të Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. ***, datë 03.07.2018, kryesues i së cilës ka qenë subjekti i rivlerësimit, për këtë vendim është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë.

63.17 Denoncim⁶⁹ i shtetasit B.Ç.

Denoncuesi ankohet ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. ***, datë 05.07.2018, me kryesues subjektin e rivlerësimit. Ankimi i përket shqyrtimit të themelit të çështjes, garant i së cilës është gjykata e shkallës më të lartë.

63.18 Denoncim⁷⁰ i Unionit Shqiptar Kursimi Kredi, Shoqëria Kursimi Kredi “***”.

Denoncuesi ankohet për shkelje ligjore në vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. ***, datë 19.07.2018, me objekt, *kthim shume*. Çështja rezulton të jetë për gjykim në Gjykatën e Lartë.

63.19 Denoncim⁷¹ i shtetasit Xh.M.

Denoncuesi ankohet ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. ***, datë 23.11.2017, me kryesues subjektin e rivlerësimit, vendim për të cilin është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë.

63.20 Denoncim⁷² i shtetasit L.LL.

Denoncuesi ankohet ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. ***, datë 19.07.2018, me kryesues subjektin e rivlerësimit, vendim për të cilin është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë.

VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

64. Neni Ç, i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se: *"Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale"* sipas neneve D, DH dhe E të këtij Aneksi dhe ligjit nr. 84/2016.

64.1 Neni E i Aneksit të Kushtetutës parashikon:

1. *Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen një rivlerësimi të aftësisë profesionale, me qëllim identifikimin e atyre, të cilët nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale që mund të korrigjohen përmes edukimit.*
2. *Vlerësimi i aftësisë për gjyqtarët, këshilltarët ligjorë ose ndihmësit ligjorë përfshin aftësinë për të gjykuar, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave gjyqësore, cilësitë personale dhe angazhimin profesional, bazuar në standardet e parashikuara në ligj*

⁶⁸ Nr. *** prot., datë 31.07.2018.

⁶⁹ Nr. *** prot., datë 2.08.2018.

⁷⁰ Nr. *** prot., datë 19.11.2018 dhe datë 15.08.2018.

⁷¹ Nr. *** prot., datë 17.09.2018.

⁷² Nr. *** prot., datë 08.08.2018.

3. Në rast se rezulton se subjekti i rivlerësimit ka njohuri, aftësi, gjykim ose sjellje të cekëta, ose ka një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij, atëherë kjo konsiderohet mangësi profesionale dhe zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të pezullimit, shoqëruar me detyrimin për të ndjekur programin e edukimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.
4. Në rast se rezulton se subjekti i rivlerësimit ka njohuri, aftësi, gjykim ose sjellje të papërshtatshme, ose ka një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij dhe mangësia e vërejtur nuk mund të korrigjohet përmes programit njëvjeçar të edukimit, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.
5. Në rast se subjekti i rivlerësimit kryen veprime për të penguar ose vështirësuar vlerësimin e tij, ose rezulton se ka njohuri, aftësi, gjykim, qëndrime, ose një model pune aq të dobët sa që rrezikon ose cenon të drejtat e qytetarëve, ai konsiderohet i papërshtatshëm për të ushtruar funksionin. Në këtë rast zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

64.2 Sipas nenit 40 të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: "Objekti i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i veprimtarisë etike dhe profesionale të subjekteve të rivlerësimit në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve".

Sipas nenit 42, paragrafi 1, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: "1. Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë, si dhe të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët vlerësohen bazuar në burimet e parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve."

Sipas nenit 43, paragrafi 1, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: "1. Procedura e vlerësimit kryhet në përputhje me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve, për aq sa është i zbatueshëm."

64.3 Ligji nr. 96/2016 "Për Statusin e gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", përcakton: "niveлин profesional të prokurorit" si vijon:

Neni 72

64.3.1 Aftësitë profesionale të gjyqtarit

1. Me anë të kriterit të aftësisë profesionale të gjyqtarit vlerësohet aftësia profesionale e gjyqtarit në drejtim të njohurive ligjore dhe arsytimit ligjor.

2. Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e gjyqtarit për të marrë vendime gjyqësore, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave, për të përdorur parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës dhe aftësinë për të analizuar jurisprudencën.

3. Aspekti i arsytimit ligjor të gjyqtarëve në marrjen e vendimeve vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si qartësia dhe kuptueshmëria e vendimit, struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit, si dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik.

4. Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.

Neni 74

64.3.2 Aftësitë organizative

1. *Me anë të kriterit të aftësisë organizative vlerësohet aftësia e magjistratit për të përballuar ngarkesën e punës dhe për të kryer procedurat hetimore ose gjyqësore, si dhe aftësia për të administruar dosjet gjyqësore, duke shmangur rrethanat, të cilat nuk varen nga magjistrati dhe që kanë efekt negativ në rezultatet e vlerësimit.*

...

3. *Në rastin e gjyqtarit, aftësia e gjyqtarit për të kryer procedurat gjyqësore matet duke u bazuar në treguesit për numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje, kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, për shmangien e seancave gjyqësore joproduktive, duke përfshirë edhe mbikëqyrjen e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit.*

..5. *Aftësia për të administruar dosjet gjyqësore ose të prokurorisë matet duke u bazuar në treguesit e rregullshmërisë, plotësisë dhe saktësisë së dokumentacionit të dosjes.*

Neni 75

64.3.3 Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

1. *Me anë të kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale vlerësohet aftësia e magjistratit për etikën në punë, integritetin dhe paanësinë.*

2. *Etika në punë e magjistratit, në lidhje me angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion, matet duke u bazuar në treguesit e dalë nga burimet e vlerësimit, të tilla si rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre, ...*

...

4. *Paanësia e magjistratit, në lidhje me kujdesin e tij ndaj konfliktit të interesit ...*

Neni 77

64.3.4 Burimet e vlerësimit

Vlerësimi i magjistratëve bazohet në këto burime:

...

c) *dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim, sipas nenit 91, të këtij ligji, duke përfshirë edhe regjistrimet e seancave me mjete audio ose video, në lidhje me dosjet gjyqësore, të cilat duhet të mbulojnë plotësisht të gjitha llojet e çështjeve të gjykuara dhe të hetuara;*

...

dh) *të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj magjistratit gjatë periudhës së vlerësimit;*

...

Neni 79

64.3.5 Kriteret për vlerësimin e veprimtarisë së kryetarit

Vlerësimi i veprimtarisë së kryetarit të një gjykate ose prokurorie kryhet bazuar në këto kritere:

a) *aftësitë drejtuese dhe organizative;*

b) *aftësitë e komunikimit.*

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

65. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjo

subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, rezulton i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale si edhe nga vlerësimi tërësor në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 61, pika 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Hysni Demiraj, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 15.02.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Roland Ilia
Kryesues

Etleda Çiftja
Anëtare

Pamela Qirko
Relatore

Olsida Goxhaj
Sekretare gjyqësore